

**BANKA E SHQIPËRISË**

**Buletini i Bilancit të Pagesave 2003**

**Dhjetor 2003**

Nëse përdorni të dhënat e këtij botimi jeni të lutur të citoni burimin.  
Botuar nga: Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr. 1, Tiranë.  
Tel.: 222230; 222152; 235568; 235569  
Faks: 355 4 223558  
[www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)

Për informacione lidhur me këtë publikim, lutemi kontaktoni Sektorin e  
Publikimeve, Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun  
e-mail: [public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org)

Personi përgjegjës: Diana Shtylla  
Argita Frashëri

Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë  
Tirazhi: 1000 kopje

## **Buletini i bilancit të pagesave për vitin 2003**

Pasqyra e lëndës:

<i>Hyrje</i>	4
<i>I. Ecuria e bilancit të pagesave të Shqipërisë gjatë dekadës së fundit</i>	4
<i>II. Zhvillime të përgjithshme në bilancin e pagesave gjatë vitit 2003</i>	6
<i>II.1. Llogaria korente gjatë vitit 2003</i>	7
<i>II.1.1. Tregtia e jashtme</i>	8
<i>II.1.2. Shërbimet</i>	15
<i>II.1.3. Të ardhurat</i>	20
<i>II.1.4. Transfertat korente</i>	20
<i>II.2. Llogaria kapitale dhe financiare</i>	22
<i>II.2.1. Investimet direkte</i>	23
<i>II.2.2 Investimet e portofolit</i>	25
<i>II.2.3. Investime të tjera</i>	26
<i>III.3. Rezervat</i>	26
<i>IV. Aneks metodologjik</i>	28
<i>V. Aneks: Rezultate të vrojtimeve</i>	31
<i>V.1. Analizë e rezultateve të vrojtimit të turizmit për vitet 2002-2003</i>	33
<i>V.2. Analizë e rezultateve të anketës për opinionin e konsumatorit – rubrika e të ardhurave nga emigrantët</i>	37
<i>VI. Aneks statistikor</i>	44


## HYRJE

Statistikat e bilancit të pagesave për çdo shtet, reflektojnë aktivitetin e tij ekonomik dhe financiar ndërkombëtar për një periudhë të caktuar kohe. Bilanci i pagesave për Shqipërinë për çdo vit, tremujor apo muaj, evidenton importet në mallra, në shërbime, në njerëz (punë) dhe në kapital që Shqipëria ka siguruar nga pjesa tjetër e botës. Në të njëjtën mënyrë, statistikat e bilancit të pagesave na ndihmojnë për të analizuar dhe për të vlerësuar potencialin e Shqipërisë për t'i ofruar botës eksporte në mallra, shërbime, punë dhe kapital. Çdo gjë që shqiptarët ose më saktë njësitë rezidente në Shqipëri, blejnë nga jorezidentët duhet paguar në një mënyrë ose në një tjetër. Mënyrat e mundshme të pagimit, të cilat përgjithësisht kombinohen, janë eksportet në mallra dhe shërbime, transfertat korente apo kapitale hyrëse, rezervat valutore, shitja e mjeteve në pronësi të rezidentëve, huamarrja nga jashtë apo çfarëdo forme e investimit të huaj. Në mënyrë që bilanci i pagesave të jetë gjithnjë në ekuilibër, llogaritë korente dhe financiare duhet të balancojnë njëra-tjetrën. Kjo do të thotë që sa më i madh të jetë deficitin korent, aq më të shumta duhet të jenë hyrjet në llogarinë kapitale dhe financiare.

### I. Ecuria e bilancit të pagesave të Shqipërisë gjatë dekadës së fundit.


Shqipëria prej të paktën një dhjetëvjeçari ose që kur nisën të hartoheshin statistikat e bilancit të pagesave, ka krijuar një profil të sajën në marrëdhëniet me botën e jashtme. Ky profil karakterizohet nga importet të larta në mallra dhe shërbime, nga prurje të mëdha në formën e transfertave korente dhe nga investime direkte modeste të lidhura kryesisht me procesin e privatizimit në vend. Eksportet e mallrave kanë qenë historikisht disa herë më të ulëta se importet e mallrave, ndërkohë që eksportet e shërbimeve kanë qenë të krahasueshme me importet, duke rezultuar herëpashere në bilance pozitive të shërbimeve.

Grafik 1. Llogaritë e bilancit të pagesave në vitet 1994-2003 (në milionë usd).



Partnerët kryesorë të Shqipërisë jo vetëm në tregti, por edhe në fushën e shërbimeve, të asistencës teknike, të transfertave korente, të investimeve direkte etj., kanë qenë Italia dhe Greqia të pasuara nga shtete të tjera fqinje si edhe nga një numër shtetesh të tjera të Bashkimit Evropian. Importet e mallrave dhe shërbimeve janë financuar kryesisht nga hyrjet në kategorinë e transfertave korente, të cilat kanë qenë vazhdimisht mbi nivelin 10 për qind e PBB-së, si edhe nga hyrjet në llogarinë kapitale dhe financiare. Rezervat valutore të autoritetit monetar kanë ardhur duke u rritur nga viti në vit, duke kapur në fund të vitit 2003 rreth 1 miliardë dollarë (USD).

**Grafik 2. Llogaria korente neto në vitet 1994-2003 (në milionë usd).**



Ndryshimet ekonomike, politike dhe sociale që kanë karakterizuar Shqipërinë gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, kanë bërë që bilanci korent i saj, ashtu si treguesit e tjerë makroekonomikë, të luhatet dukshëm duke kaluar nga vlerat pozitive të viteve 1994-1995 në deficitin e theksuar të vitit 1997. Deficiti korent nuk është i panjohur për ekonominë në tranzicion. Përgjithësisht, ndryshimet strukturore për këto ekonomi kanë sjellë mosbalancime korente të pranishme për periudha disavjeçare. E njëjta dukuri është vërejtur edhe në Shqipëri.

Importet e rritura në mallra dhe shërbime, në mungesë të eksporteve të niveleve të krahasueshme, kanë gjeneruar vazhdimisht deficite korente. Fakti që deficiti korent ka qenë i pranishëm prej mëse një dekade dhe fakti që ai përgjithësisht ka ardhur duke u rritur që pas vitit 1998, tregon që financimi i deficitit korent duhet të jetë në qendër të vëmendjes së politikave ekonomike. Një deficit korent që regjistrohet vit pas viti, akumulon borxh të jashtëm, duke rritur nivelin e detyrimeve për ripagime dhe për pagesa interesi. Shqipëria deri në fund të vitit 2003, sipas të dhënave të disponueshme, ka grumbulluar një borxh të jashtëm zyrtar prej 1.2 miliardë dollarësh. Ky nivel borxhi, si në terma absolutë, ashtu edhe i vlerësuar ndaj PBB-së apo si stok detyrimesh për frymë, është dukshëm më i ulët se ai i vendeve të tjera në tranzicion.

## II. Zhvillime të përgjithshme në bilancin e pagesave gjatë vitit 2003.

Bilanci i pagesave për vitin 2003 nuk ka regjistruar ndryshime të theksuara në llogaritë e veçanta të tij në krahasim me një vit më parë. Kjo do të thotë që edhe ky vit, ashtu si viti 2002, u mbyll me deficit korent (-407 milionë usd), me bilanc pozitiv në llogarinë kapitale dhe financiare (359 milionë usd) dhe me rritje të rezervave valutore (me rreth 100 milionë usd).

Deficiti, si në kategorinë e mallrave ashtu edhe në atë të shërbimeve ka ardhur duke u rritur. Ky deficit për vitin 2003 ishte 22.7 për qind e PBB-së. Paralelisht me thellimin e këtij deficiti, është regjistruar rritja e suficiteve në kategoritë 'të ardhura' dhe 'transferta korente'. Hyrjet neto të kapitalit kanë mbuluar rreth 90 për qind të deficitit korent. Detyrimet financiare neto të Shqipërisë ndaj jorezidentëve janë rritur me 328 milionë usd, dhe janë përfaqësuar pothuajse tërësisht nga investimet e huaja direkte dhe nga huamarrja zyrtare dhe private. Rritje gjatë këtij viti është regjistruar edhe në mjetet e rezidentëve jashtë, të përfaqësuara nga depozita, investime portofoli dhe valutë në pronësi të rezidentëve.

Rezervat valutore gjatë vitit 2003 janë rritur me rreth 100 milionë dollarë. Gjatë vitit 2003 tregu i brendshëm valutor ka regjistruar mbiçmim të lekut ndaj dy monedhave kryesore, në të cilat vendi kryen transaksionet korente dhe kapitale dhe konkretisht ndaj euros dhe dollarit amerikan. Mbiçmimi i lekut ndaj dollarit ka qenë dukshëm më i lartë sesa ai ndaj euros. Në krahasim me fundin e vitit 2002, në fund të vitit 2003 leku u paraqit i mbiçmuar me rreth 20.85 për qind kundrejt dollarit dhe me 3.06 për qind kundrejt monedhës së përbashkët evropiane.

Hartimi i bilancit të pagesave në dollarë amerikanë, ndërkohë që ekonomia shqiptare është kryesisht e orientuar për nga Eurozona, sidomos në një periudhë gjatë së cilës dollari amerikan ka humbur ndjeshëm pikë ndaj euros, bën që analiza e ecurisë së bilancit të pagesave të mos paraqesë besnikërisht ndryshimet vit-në-vit të transaksioneve korente dhe atyre kapitale.

Zëri 'gabime dhe harresa neto', edhe për vitin 2003, vazhdon të jetë i pranishëm me një vlerë jo të vogël në bilancin tonë të pagesave, duke reflektuar mungesat në mbulimin e burimeve raportuese, praninë e ekonomisë joformale dhe të pamatur etj.. Fakti që ky zë ka shënuar vlera pozitive që prej vitit 1995, tregon që statistikën e bilancit të pagesave kanë paraqitur një nënregjistrim sistematik të importeve në llogarinë korente, apo të daljeve të kapitalit në llogarinë financiare.


Tabelë 1. Bilanci i pagesave për vitet 2002 - 2003

Bilanci i Pagesave		
(Në milionë dollarë amerikanë)		
	Viti 2002	Viti 2003
Llogaria korente	(420.8)	(406.7)
Eksporti i mallrave	330.2	447.2
Importi i mallrave	(1,485.4)	(1,783.5)
Bilanci tregtar	(1,155.1)	(1,336.3)
Shërbimet: Kredi	585.0	719.7
Shërbimet: Debi	(590.3)	(802.4)
Të ardhurat: Kredi	146.9	194.8
Të ardhurat: Debi	(20.6)	(24.4)
Transferta private pa shpërblim	575.0	781.7
Transferta shtetërore pa shpërblim	38.2	60.3
Llogaria kapitale	121.2	157.0
Llogaria financiare	206.9	202.0
Investime direkte	135.0	178.0
Investime portofoli	(36.8)	(22.5)
Kapitale të tjera*	103.4	35.3
Gabime dhe harresa neto	121.3	147.4
Bilanci i përgjithshëm	28.6	99.6
Rezervat dhe zëra të lidhur me to.		
Mjetet e rezervës	(28.6)	(99.6)
Përdorim huash e kredish nga FMN	5.3	11.1
Për t'u mbajtur në vëmendje		
Ndryshimi total në rezerva	(109.9)	(175.6)
nga të cilat: ndryshim nga kursi i këmbimit	65.0	87.0


## II.1. Llogaria korente gjatë vitit 2003

Llogaria korente e Shqipërisë në vitin 2003 ruajti pothuajse të njëjtat karakteristika me një vit më parë. Madhësia e ekonomisë dhe tiparet e saj bëjnë që ajo të mos ndikohet ndjeshëm nga zhvillimet në ekonominë botërore, pavarësisht nga kahu i këtyre të fundit. Deficiti korent i vitit 2003 ishte pothuajse i njëjtë me atë të vitit 2002 duke shënuar – 407 milionë usd ose –6.7 për qind të PBB-së. Kërkesa e brendshme vazhdoi të nxishte rritjen e importeve, ndërkohë që rritja e eksporteve, edhe pse më e madhe se ajo e viteve të tjera, nuk mjaftoi për të ngushtuar deficitin tregtar. Importet e mallrave (në vlerë) u rritën me 20 për qind ndërsa eksportet me 35 për qind.

Grafik 3. Shpërndarja e hyrjeve (të ardhurat) dhe e daljeve (shpenzimet) në llogarinë korente (në %)



Të ardhurat në llogarinë korente (%)




Shpenzimet në llogarinë korente (%)

Për pasojë deficiti tregtar i regjistruar në vitin 2003 ishte 1.3 miliardë dollarë ose 15.6 për qind më i lartë se deficiti i regjistruar vjet. Ky deficit është balancuar nga suficitet në të ardhura dhe në transferta korente të cilat, së bashku, regjistruan një bilanc pozitiv prej rreth 1 miliardë dollarësh. Shërbimet gjatë vitit 2003 regjistruan një bilanc negativ prej 87 milionë dollarësh. Thellimi i deficitit të shërbimeve, në krahasim me vitin e kaluar, ka ardhur kryesisht si pasojë e ngushtimit të suficitit të zërit 'udhëtime' dhe si pasojë e ndryshimit të kahut të bilancit në 'shërbimet e tjera'.

### II.1.1. Tregtia e jashtme

Vëllimi i shkëmbimeve tregtare në mallra (import+eksport) për vitin 2003 ishte 2.2 miliardë usd ose 22.8 për qind më i lartë krahasuar me vitin paraardhës. Tregtia në mallra për këtë periudhë ka përfaqësuar 54 për qind të transaksioneve korente të Shqipërisë me pjesën tjetër të botës. Shpenzimet për importe kapën shifrën 1.8 miliardë usd. Rritja vjetore në këto shpenzime ishte 290 milionë usd ose 20 për qind, ndërkohë që të ardhurat nga eksporti i mallrave regjistruan 447 milionë usd, duke qenë 117 milionë usd ose 35 për qind më të larta se ato të vitit parardhës. Shkalla e mbulimit të importeve nga eksportet vlerësohet në nivelin 25 për qind nga 22 për qind në vitin 2002.

**Grafik 4. Bilanci tregtar në vitet 1994-2003 (në milionë usd).**



Megjithëse nga viti në vit, si importet ashtu edhe eksportet e mallrave kanë ardhur në rritje, importet janë karakterizuar nga një trend rritës më i lartë dhe më i qëndrueshëm sesa eksportet e mallrave (Grafik 4). Si pasojë e kësaj dinamike deficiti tregtar është rritur gradualisht që prej vitit 1997, duke u luhatur midis niveleve 18 dhe 24 për qind të PBB-së. Deficiti tregtar për vitin 2003 ishte rreth 1.3 miliardë dollarë ose 16 për qind më i lartë krahasuar me vitin paraardhës.

Variacioni në grupmallra dhe vëllimi i madh i importeve (28.4 për qind e PBB-së) pasqyrojnë kërkesën në rritje të vendit për mallra konsumi, mallra të ndërmjetëm dhe mallra kapitale. Rënia e importeve të disa grupmallrave në periudhat kur në tregje del prodhimi vendas (kryesisht prodhime bujqësore), tregon se prodhimi vendas akoma nuk është në gjendje të plotësojë në nivel të kënaqshëm kërkesat e rezidentëve për sasi dhe cilësi në mallra. Importet prej vitesh plotësojnë kërkesën e



Shqipërisë për mallra që nuk mund të prodhohen apo që prodhohen në vend me kosto më të lartë dhe cilësi më të ulët nga ajo që ofrohet prej shteteve partnere. Nga ana tjetër, karakteristikat e eksporteve (vëllimi i vogël dhe shkalla e ulët e diversifikimit) pasqyrojnë kapacitetin e kufizuar të ekonomisë vendase për të ofruar në tregun ndërkombëtar mallra konkurrues. Deficiti i lartë dhe rregullisht në rritje i tregtisë së jashtme duhet të tërheqë vëmendjen drejt politikave që synojnë zëvendësimin e importeve dhe nxitjen e eksporteve.

## - Eksporti i mallrave


Gjatë vitit 2003 eksportet janë rritur me 35.4 për qind ose me 117 milionë dollarë. Kontributin kryesor në rritjen e eksporteve shqiptare e kanë dhënë riekportet (eksporte me material porositësi), të cilat dominojnë eksportet shqiptare.

Tabelë 2. Eksporti sipas klasifikimit SITC (në milionë usd).

KODI	PËRSHKRIMI	2001	2002	2003	2001	2002	2003	2003/2002
		<i>Vlera në milionë usd</i>			<i>Struktura në %</i>			<i>Ndryshimi në %</i>
0	Ushqime dhe kafshë të gjalla	11.2	5.2	18.9	3.7	1.6	4.2	264.3
1	Pije dhe duhan	6.5	6.2	5.8	2.1	1.9	1.3	-6.1
2	Materiale të papërpunuara	11.6	13.3	19.4	3.8	4.0	4.3	46.2
3	Lëndë djegëse	4.4	7.0	4.9	1.5	2.1	1.1	-30.4
4	Yndyrna bimore dhe shtazore	0.0	0.0	0.5	0.0	0.0	0.1	...
5	Produkte kimike	3.8	2.2	2.9	1.2	0.7	0.6	31.2
6	Mallra të përpunuar	54.7	57.6	77.5	17.9	17.4	17.3	34.5
7	Makineri dhe pajisje	8.0	9.3	15.8	2.6	2.8	3.5	70.0
8	Mallra të tjerë të përpunuar	204.4	229.5	301.5	67.1	69.5	67.4	31.4
9	Mallra të paklasifikuar diku tjetër	0.0	0.0	0	0.0	0.0	0.0	...
	TOTAL	304.6	330.2	447.2	100.0	100.0	100.0	35.4


Gjithashtu rritje është regjistruar në eksportet nga prodhimi i brendshëm (rritje me 18 për qind). Këto të fundit, pavarësisht nga rritja në terma absolutë gjatë viteve të fundit, vazhdojnë të zënë një pjesë të vogël të eksporteve të përgjithshme. Arsye pas ecurisë së ngadaltë të eksportit të brendshëm janë kryesisht cilësia e ulët dhe kostoja e lartë e prodhimit. Këta faktorë i bëjnë mallrat vendas më pak konkurrues në tregjet e huaja. Nga ana tjetër, rritja e kërkesës së brendshme, përveç presionit që ushtron mbi rritjen e importeve, luan rol edhe në zvogëlimin e tepcës për eksport.

Grafik 5. Ecuria e eksporteve nga prodhimi i brendshëm në vlerë dhe si pjesë e eksporteve totale.



Eksporti i brendshëm shqiptar përfaqësohet kryesisht nga eksporti i metaleve (nën kategorinë 'mallra të përpunuar'), prodhime bujqësore, prodhime lëkure, lëndë drusore dhe prodhime minerale (karburante). Rritja e çmimit të kromit në tregjet ndërkombëtare, pas 6 vjetësh rënieje të vazhdueshme, ofroi mundësinë për gjallërimin e industrisë minerare të kromit në Shqipëri. Çmimi i ferrokromit në tregjet e huaja, afërsisht 600 usd/ton, çoi në rritje të vëllimit dhe të të ardhurave nga eksportet e kromit. Aktualisht, në vendin tonë, në këtë industri ushtrojnë aktivitet 109 subjekte private<sup>1</sup>. Të ardhurat nga eksporti i metaleve bazë për vitin 2003 rezultuan 61 për qind më të larta në krahasim me të ardhurat e vitit parardhës. Megjithë rritjen e çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare, kërkesa e lartë brenda vendit bëri që eksportet e kategorisë 'lëndë djegëse' të ishin më të ulëta sesa ato të vitit 2002.

**Grafik 6. Eksporti nga prodhimi i brendshëm sipas grupmallrave (në milion usd).**



### -Importi i mallrave.

Shpenzimet për importin (në vlerë c.i.f.) e mallrave kanë ardhur në rritje nga viti në vit. Për vitin 2003 ato vlerësohen në nivelin 1857 milionë usd. Importet në të gjitha kategoritë e grupmallrave kanë regjistruar rritje të ndjeshme.

**Tabelë 3. Importi sipas klasifikimit SITC (në milionë usd).**

KODI	PËRSHKRIMI	2001	2002	2003	2001	2002	2003	2003/2001
		<i>Vlera në milionë usd</i>			<i>Struktura në %</i>			<i>Ndryshi mi në %</i>
0	Ushqime dhe kafshë të gjalla	186.1	218.4	268.1	14.0	14.7	14.4	22.7
1	Pije dhe duhan	48.5	56.6	68.8	3.7	3.8	3.7	21.5
2	Materiale të papërpunuara	51.6	58.1	63.7	3.9	3.9	3.4	9.6
3	Lëndë djegëse	134.4	136.2	158.9	10.1	9.2	8.6	16.7
4	Yndyrna bimore dhe shtazore	19.8	20.8	29.0	1.5	1.4	1.6	39.4
5	Produkte kimike	101.5	122.1	159.7	7.7	8.2	8.6	30.8
6	Mallra të përpunuara	287.0	338.5	441.0	21.7	22.8	23.7	30.3
7	Makineri dhe pajisje	314.0	321.3	403.4	23.7	21.6	21.7	25.5
8	Mallra të tjera të përpunuara	181.8	215.2	264.7	13.7	14.5	14.3	23.0
9	Mallra të paklasifikuara diku tjetër	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	...
	<b>TOTAL</b>	<b>1324.8</b>	<b>1487.3</b>	<b>1857.2</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>24.9</b>

<sup>1</sup> Burimi: Ministria e Industrisë dhe Energjetikës

Ndikimin më të madh në rritjen e importeve e kanë dhënë importet në makineri e pajisje (rritje vjetore prej 25 për qind), të cilat zënë një peshë të konsiderueshme në importet e përgjithshme. Ndërkohë që rritja në importet e mallrave të konsumit evidenton mangësitë e ekonomisë shqiptare, rritja në importet e mallrave kapitale, nga ana tjetër, është tregues i ecurisë së kënaqshme të investimeve në vend. Importet më të larta në mallra kapitale kanë qenë ato të pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit (media elektronike, valë komunikimi) si edhe pajisjet e përdorura për rinovimin e rrjetit energjitik në vend.

- Megjithë rritjen e vazhdueshme të çmimit të karburanteve në tregjet ndërkombëtare, kërkesa e brendshme për karburante ka vazhduar të jetë e lartë, duke bërë që sasia e importuar gjatë vitit 2003 të ishte 19 për qind më e madhe në krahasim me një vit më parë.

- Ecuria pozitive e prodhimit të energjisë elektrike në vend gjatë vitit 2003, shkaktoi rënie të importeve në energji elektrike në krahasim me vitin paraardhës. Gjatë këtij viti janë importuar 561 milionë kwh më pak se një vit më parë, gjë që ka çuar në uljen e shpenzimeve për import të energjisë me rreth 17 për qind.

- Kushtet atmosferike jo të favorshme për prodhimin bujqësor dhe frutikulturën në vend, çuan në rritje të importeve në produkte vegjetale (18 për qind), ndër të cilat ndjeshëm janë rritur importet e drithërave, të zarzavateve dhe të frutave.

- E lartë mbetet kërkesa për importet në ushqim, pije dhe duhan, të cilat gjatë këtij viti kanë shënuar një rritje prej 21 për qind. Një zhvillim për t'u përmendur në këtë grup, është rritja prej 29 për qind e sasisë së importuar të duhanit, gjë që ka ardhur kryesisht si pasojë e luftës kundër evazionit fiskal. Edhe në të ardhmen, vazhdimësia e këtij procesi, pritet të ketë rezultat në importet e regjistruara të mallrave që janë subjekt i akcizës.

- Importet e lëndës së parë për përpunim aktiv (tekstile, veshje të këmbëve dhe metale) u rritën me rreth 34 për qind. Ecuria e këtyre importeve reflekton zhvillimet e vërejtura në sektorin e rieksporëve.

### **-Tregtia nga industria e përpunimit aktiv**


Prej vitesh tashmë, tregtia e jashtme e Shqipërisë reflekton aktivitetin e përpunimit aktiv me material të porositësit. Ky proces nënkupton prodhimin e mallrave të ndërmjetëm apo përfundimtarë duke përdorur lëndë të parë të importuar, me qëllim riekспортin e këtyre mallrave drejt vendeve porositëse.

Rritja, nga viti në vit, e rieksporëve është pa dyshim një tregues i ristrukturimit të vazhdueshëm edhe pse të ngadaltë të ekonomisë shqiptare. Kjo ecuri reflekton zgjerimin e kapaciteteve prodhuese si dhe një rritje të produktivitetit. Industria e përpunimit aktiv përfaqësohet, përgjithësisht, nga aktiviteti i subjekteve me kapital të huaj, të organizuara në kompani të vogla dhe të mesme.

Prej vitit 1996, gjatë të cilit u hapën mjaft subjekte të industrisë përpunuese në vend, ky aktivitet ka ardhur në rritje nga viti në vit. Me një vëllim prej 680 milionë dollarësh, tregtia nga industria e përpunimit aktiv në vend zë rreth 30 për qind të transaksioneve tregtare të zhvilluara gjatë këtij viti. Më i ndjeshëm është ndikimi i

kësaj tregtie në eksporte. Në këto të fundit rieksporitet zënë rreth 77 për qind të totalit, ndërkohë që, importet e lëndëve të para për përpunim të mëtejshëm ishin rreth 18 për qind e importeve totale gjatë vitit 2003.


**Grafik 7. Tregtia nga përpunimi aktiv ndaj tregtisë totale (import+eksport në milionë usd).**



Fakti që tregtia nga përpunimi aktiv ka regjistruar bilance pozitive nga viti 1999 e këtej, tregon se industria vendase ka ardhur duke rritur vlerën e shtuar të mallrave nga përpunimi, duke bërë që të ardhurat nga eksporti të tejkalojnë shpenzimet për importin e lëndëve të para.

Industria e përpunimit me material të porositësit është e përqendruar kryesisht në përpunimin e mallrave tekstilë, në prodhimin e veshjeve të këmbës, në përpunimin e lëkurës dhe të metaleve. Shkëmbimet tregtare për këto grupmallra përfaqësojnë 87 për qind të të gjithë industrisë përpunuese. Investitorët kryesorë në këtë industri vijnë nga Italia dhe Greqia.

**Grafik 8. Aktiviteti i industrisë së përpunimit aktiv sipas shteteve dhe grupmallrave.**



**Partnerët tregtarë në përqindje.**

**Vëllimi tregtar sipas grupmallrave në milionë usd.**

### -Tregtia sipas partnerëve tregtarë

Nga pikëpamja gjeografike, aktiviteti tregtar i Shqipërisë mbetet i orientuar drejt vendeve të Bashkimit Evropian. Shkëmbimet tregtare me këtë grup shtetesh zënë rreth 68 për qind të importeve dhe 93 për qind të eksporteve. Italia dhe Greqia përfaqësojnë partnerët kryesorë brenda këtij grupimi. Normat e rritjes së importeve dhe eksporteve me vendet e Bashkimit Evropian flasin për një thellim të tregtisë me këto vende. Ndërkohë, tregtia e Shqipërisë me vendet e rajonit të Evropës Juglindore (EJL) të përfshira në procesin e krijimit të zonës të lirë tregtare, mbetet e kufizuar. Ajo paraqet një sjellje rastësore dhe nuk shfaq një model të mirëfilltë tregtar.

**Tabelë 4. Shpërndarja e import/eksporteve sipas partnerëve tregtarë në vite dhe ndryshimi vjetor për vitin 2003. Importet janë në vlerën c.i.f.**

Partnerët tregtarë	Pesha në totalin e importit (në %)			Ndryshimi (2003/2002)	Pesha në totalin e eksportit (në %)			Ndryshimi (2003/2002)
	2001	2002	2003	%	2001	2002	2003	%
<b>Vitet</b>	<b>2001</b>	<b>2002</b>	<b>2003</b>	<b>%</b>	<b>2001</b>	<b>2002</b>	<b>2003</b>	<b>%</b>
Total	100.0	100.0	100.0	24.9	100.0	100.0	100.0	35.4
Vendet e BE - 15	74.2	71.1	68.3	14.5	91.6	92.1	93.3	37.1
Itali	31.9	34.7	34.1	17.6	71.2	71.7	74.9	41.4
Greqi	25.8	21.9	19.8	1.7	13.1	12.8	12.9	35.7
Gjermani	5.8	5.6	5.7	42.8	5.5	5.5	3.4	-16.8
Vendet e Europës Juglindore	5.8	7.1	6.1	2.9	4.7	3.8	4.3	20.8
Bullgaria	2.0	1.9	2.2	40.8				
Bosnja & Hercegovina	0.0	0.0	0.1	83.6				
Kroacia	1.3	2.2	1.5	-12.2				
Ish-Jugosllavia	0.5	0.8	0.6	-23.8	3.1	2.2	2.6	41.7
IRJ e Maqedonisë	1.1	1.1	0.9	-4.8	1.5	1.5	0.7	-37.1
Rumania	0.9	1.1	0.9	-6.1				
Turqia	6.2	6.1	6.5	31.4				
Rusia	1.4	2.6	2.9	46.8				
Ukrahina	1.1	1.2	2.3	205.0				
Të tjera vende	11.4	11.8	13.9	22.6	3.7	4.1	2.4	45.2

## Box 1. Marrëveshjet e tregtisë së lirë

Deri në fund të vitit 2003 Shqipëria kishte nënshkruar Marrëveshje të Tregtisë së Lirë me: Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, me Kroacinë, me Bullgarinë dhe me Kosovën. Në linja të përgjithshme, këto marrëveshje, paraqesin detyrimin e dyanshëm të Shqipërisë dhe të shtetit partner për të reduktuar në mënyrë të shkallëzuar, pra në etapa të caktuara deri në pikën e eliminimit të plotë të tyre, tarifat doganore për tregtinë e mallrave.

Në krahasim me vitin 2002 vëllimi tregtar me IRJ të Maqedonisë është ulur. Megjithatë, vërehet rritje e eksporteve të produkteve të MTL-ve. Me hyrjen në fuqi të MTL me IRJ të Maqedonisë, produktet, në të cilat është regjistruar një rritje e eksporteve janë: produktet vegjetale, përgatitjet ushqimore, pijet, duhani, produktet minerale dhe prodhimet e mobiljeve. Shkëmbimet tregtare me Kroacinë konsistojnë kryesisht në importe. Gjatë vitit 2003, tregtia vlerësohet në rënie krahasuar me një vit më parë (11.6%). Tregtia me Bullgarinë ka pësuar një rritje prej rreth 41 për qind në krahasim me vitin 2002. Përqendrimi më i madh i importeve është në produktet minerale (31%) dhe konkretisht në lëndët djegëse dhe energji elektrike. Eksportet me Bullgarinë megjithëse shënojnë rritje, mbeten në nivel të ulët. Me një vëllim importesh prej rreth 4 milionë usd dhe me eksporte prej rreth 8 milionë usd, bilanci tregtar me Kosovën rezulton pozitiv. Importet nga Kosova dominohen nga importet në mjete transporti dhe në metale bazë. Eksportet tona në drejtim të Kosovës përfaqësohen nga produkte vegjetale (kryesisht miell dhe kafe), përgatitje ushqimore dhe produkte minerale (karburante). Importet prej të gjitha vendeve të rajonit gjatë vitit 2003 kanë qenë 110 milionë usd, ndërsa eksportet e Shqipërisë drejt këtyre vendeve vetëm 14 milionë usd.


Të dhënat sugjerojnë se MTL me vendet e rajonit deri tani nuk kanë pasur efekte të ndjeshme pozitive për Shqipërinë.

Gjatë periudhës së aplikimit të tarifave të reduktuara shtetet partnere janë treguar më agresive për të shfrytëzuar mundësitë për tregti në kushte lehtësuese. Marrëveshje të tilla, përveç mundësive për fitim, mbartin edhe rrezikun e ekspozimit ndaj konkurrencës në tregje, për të cilat vendi mund të mos jetë plotësisht ose mjaftueshmërisht i përgatitur. Për këtë arsye, është e nevojshme të hartohen politika dhe programe të orientuara drejt mbështetjes së prodhimit vendas dhe sidomos të sektorëve që kontribuojnë për eksporte. Krijimi i kushteve për kontrollin e produkteve, për ngritjen e cilësisë së tyre, për uljen e kostove të prodhimit, të etiketimit apo të transportit, për aplikimin e standardeve bashkëkohore në të gjitha drejtimet e vlerësimit të produkteve është kusht i domosdoshëm për ta vendosur Shqipërinë në baza të përafërta konkurrence me shtetet partnere në rajon.


### I.1.2. Shërbimet

Në vitin 2003 në krahasim me vitin 2002, eksportet e shërbimeve janë rritur me 23 për qind ndërsa importet janë rritur me 36 për qind. Për rrjedhojë, kategoria e shërbimeve e mbylli vitin me një bilanc negativ prej 83 milionë dollarësh – një ndryshim i dukshëm në krahasim me bilancin prej –5 milionë dollarësh të regjistruar në fund të vitit 2002. Ky deficit relativisht i lartë krahasuar me vitet paraardhëse, nuk duhet parë si një zhvillim negativ përse i përket aktivitetit ekonomik, pasi ai është tregues i integritimit të ekonomisë shqiptare me ekonomitë e huaja. Me fjalë të tjera ky bilanc tregon se shqiptarët po kërkojnë më tepër shërbime nga jorezidentët, dhe në të njëjtën kohë janë të gatshëm për t'iu ofruar shërbime të ndryshme jorezidentëve. Ndërgjegjësimi i aktorëve të ekonomisë tonë për të rritur cilësinë dhe për të zgjeruar gamën e shërbimeve që ata ofrojnë për jorezidentët duhet vlerësuar pozitivisht. Në vitet e fundit bilanci i pagesave ka regjistruar aktivitet të dyanshëm (import/eksport) në grupe shërbimesh që më parë kanë qenë pothuajse të paeksploruar.

**Grafik 9. Struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve në llogarinë e shërbimeve për vitin 2003 sipas nënzërave kryesorë.**



**Të ardhurat në llogarinë e shërbimeve.**



**Shpenzimet në llogarinë e shërbimeve.**

#### -Shërbime udhëtimi

Peshën më të madhe në tregtinë e shërbimeve, vazhdojnë ta ruajnë shërbimet e udhëtimit të ndjekura nga shërbimet e transportit, të sigurimit dhe nga shërbimet e tjera. Shërbimet e udhëtimit karakterizohen nga një rritje vjetore relative më e madhe e shpenzimeve (34 për qind) në krahasim me të ardhurat (7 për qind). Rritja në shpenzimet për udhëtime, të cilat kapën vlerën 520 milionë dollarë, shpjegohet me rritjen e numrit të shqiptarëve (rezidentëve) që kanë udhëtuar jashtë vendit si edhe me rritjen e shpenzimeve ditore të tyre. Për importin e shërbimeve të udhëtimit, vlerësimi është rreth 490 milionë dollarë ose sa 63 për qind e totalit të dërgesave nga emigrantët. Vlen të theksohet që shqiptarët që udhëtojnë jashtë shtetit shpenzojnë më tepër për qëllime personale (këtu përfshihen pushimet, aktivitete të tjera argëtuese, edukim, trajtim shëndetësor etj.) se sa për biznes. Shpenzimet për qëllime personale janë rritur me 65 për qind, ndërkohë që ato për biznes kanë mbetur pothuajse të pandryshuara.

## Box 2. Turizmi gjatë vitit 2003.

Sektori i bilancit të pagesave, për të vlerësuar shpenzimet dhe të ardhurat nga turizmi ndërshtetëror për çdo tremujor të vitit, mbështetet në rezultatet e vrojttimeve të kryera në bashkëpunim me INSTAT në disa porte – pika kufitare- të Shqipërisë. Popullata që synohet të mbulohet nëpërmjet vrojttimeve përbëhet nga dy grupe. Njëri është grupi i turistëve rezidentë (me kombësi shqiptare ose jo) që kthehen nga udhëtimi jashtë shtetit për qëllime turizmi, dhe tjetri është grupi i turistëve jorezidentë (me kombësi shqiptare ose jo), që largohen nga Shqipëria pas një udhëtimi turistik. **Rreth 2500 turistë në vit pyeten për qëllimin e udhëtimit, gjë që mundëson ndarjen e tyre në turistë për qëllime biznesi apo për qëllime personale, për ditëqëndrimin, për shpenzimet e bëra në shtetin pritës si edhe për informacion shtesë,** që mund të jetë i vlefshëm për të analizuar turizmin në vend dhe jashtë tij. Vlerat mesatare për ditëqëndrimin dhe shpenzimet ditore për turist, kombinohen me statistikat për hyrje-daljet e turistëve të ndarë sipas kombësisë në shqiptarë dhe të huaj, të siguruara nga Ministria e Rendit. Këto të fundit modifikohen për të përjashtuar nga kategoria 'turist shqiptar' personat me origjinë dhe pasaportë shqiptare, por me rezidencë jashtë shtetit. **Pjesa më e madhe e turistëve të huaj vijnë nga Italia, Greqia dhe Maqedonia.** Po kështu, pjesa dërrmuese e udhëtarëve shqiptarë që udhëtojnë jashtë shtetit drejtohen për në këto vende dhe për në vende të tjera fqinje si Kosovë, Mal i Zi etj..

Në përfundim të analizës, përftohen të ardhurat dhe shpenzimet totale për turizmin, të cilat paraqiten në zërin 'udhëtim' në kategorinë e shërbimeve në llogarinë korente. Në bazë të rezultateve të vrojtimit për vitin 2003, në krahasim me vitin 2002, **ditëqëndrimi i turistëve shqiptarë jashtë ka ardhur duke u ulur për ata që udhëtojnë për qëllime biznesi dhe duke u rritur për ata që udhëtojnë për qëllime personale.** Pra, rezulton se biznesmenët shqiptarë i kanë shkurtuar vizitat e tyre jashtë, ndërkohë që shqiptarët që udhëtojnë për qëllime personale, dhe kryesisht për pushime, po e zgjasin kohëqëndrimin e tyre jashtë shtetit duke shpenzuar, natyrshëm, më shumë para. **Për turistët e huaj, qëndrimi për të dyja kategoritë e turistëve, luhetet rreth vlerës 10 ditë.** Turistët e huaj të të dyja kategorive qëndrojnë më shumë gjatë tremujorit të tretë sesa gjatë tremujorëve të tjerë të vitit. Përsa i përket shpenzimeve ditore, këto për turistët shqiptarë që kanë udhëtuar për arsye personale gjatë dy viteve të fundit janë luhatur midis vlerave 30 dhe 90 usd në ditë, ndërsa shpenzimet e të huajve që kanë ardhur për të njëjtat qëllime në Shqipëri, kanë arritur edhe deri në 120 usd në ditë.



Shpenzimet gjatë udhëtimeve për qëllime biznesi, si nga të huajt ashtu edhe nga shqiptarët për vitin 2002 kanë qenë në rangun 40-80 usd. **Gjatë vrojtimeve të vitit 2003, shpenzimet e raportuara nga të intervistuarit që kanë udhëtuar për qëllime biznesi kanë qenë më të larta, sidomos nga ana e udhëtarëve shqiptarë.** Për vitet 2002-2003, vrojtimi ka mundësuar hartuesit e bilancit të pagesave të vlerësojnë shërbimet e udhëtimeve si më poshtë: **të ardhura nga turizmi 487 dhe 522 milionë usd dhe shpenzime për turizëm përkatësisht 365 dhe 489 milionë usd.** Rritja në shpenzimet e turistëve shqiptarë jashtë është dukshëm më e lartë sesa rritja në të ardhura, gjë që do të thotë që në të ardhmen mund të gjendemi përballë një deficiti të shërbimeve të udhëtimit.

#### **-Shërbime transporti.**

Shërbimet e transportit janë ndikuar dukshëm nga zhvillimet në aktivitetin tregtar të mallrave, pasi transporti dhe sigurimi i mallrave zënë peshën më të madhe në nënzërat e këtyre shërbimeve. Bilanci i shërbimeve të transportit, për vitin 2003, ka regjistruar një rënie prej 20 për qind kundrejt vitit 2002. Debitë në këtë kategori shënuan 156 milionë dollarë ndërsa kreditë 69 milionë dollarë. Në vlerësimin e shërbimeve të transportit të mallrave për vitin 2003 është përdorur kostoja e re e transportit të mallrave e llogaritur në bazë të vrojtimin të tregtisë së jashtme (shih Box 3). Transporti i pasagjerëve dhe shërbimet e tjera të transportit vazhdojnë të paraqesin vlera të vogla, për shkak të vështirësisë në mbledhjen e të dhënave për këto transaksione.

#### **-Shërbime sigurimi.**

Deficiti i shërbimeve të sigurimit ka rënë ndjeshëm krahasuar me vitin 2002. Rënia me 63 për qind ose me 30 milionë dollarë, kundrejt vitit 2002, ka ardhur si pasojë e rënies së shpenzimeve për sigurimin e mallrave. Aplikimi i koeficientëve të rinj, pra vlerësimi duke përdorur një kosto më të ulët të sigurimit të mallrave ka çuar në uljen e shifrës së shpenzimeve për sigurim. Incidenca e ulët e rasteve të sigurimit të mallit si për eksportet ashtu edhe për importet (64 për qind e eksportuesve dhe 78 për qind e importuesve të intervistuar janë shprehur se nuk e sigurojnë mallin) si edhe kostoja tepër e ulët e sigurimit të mallit, tregojnë se tregtia e jashtme e Shqipërisë është ende mjaft larg standardeve, me të cilat operojnë vendet e tjera të rajonit apo më gjerë.

**Box 3. Efekti i aplikimit të koeficientëve të vlerësuar në bazë të vrojtimit të tregtisë së jashtme për transportin dhe sigurimin e mallrave, në bilancin e pagesave.**

*-Ilustrim për vitin 2003.*

Kostoja e transportit përbën një pjesë të rëndësishme të koston së transaksionit tregtar, dhe ndryshe nga përbërësit e tjerë të kësaj kostoje, është më e matshme dhe reflektohet drejtpërsëdrejti në çmimin përfundimtar të mallit. Kostoja e transportit luan rol edhe në krijimin ose në dëmtimin e avantazhit krahasimor të një vendi. Për shembull, një kosto relativisht e lartë e transportit për një pjesë të madhe të mallrave të prodhuar në një vend do të zbehte dukshëm avantazhet krahasimore të tregtisë së vendit. Duke marrë parasysh rëndësinë e koston së transportit dhe duke synuar vlerësimin e importeve në vlerën f.o.b. (free on board)<sup>1</sup> në përputhje me metodologjinë bazë të Manualit të Bilancit të Pagesave, u pa i domosdoshëm vrojtimi i tregtisë së jashtme, i cili kërkonte informacion mbi koston e transportit, mbi koston e sigurimit dhe mbi aspekte të tjera të tregtisë së jashtme në mallra. Rezultatet e këtij vrojtimi janë aplikuar gjatë hartimit të bilancit të pagesave për vitin 2003. Rezultatet e dala nga analiza e rubrikave të vrojtimit:

- **Kostoja e transportit të mallrave** në importe rezultoi **12.05 për qind e koston së përgjithshme** të transaksionit (nga 7 për qind që është aplikuar deri në vitin 2002). Kostoja e transportit të mallrave në eksporte rezultoi në nivelin 8 për qind. Nga analiza e informacionit të marrë u pa se, **si në importe ashtu edhe në eksporte, në mëse 2/3 e rasteve, kostoja e transportit përballohet nga pala shqiptare**<sup>3</sup>. Shpërndarja e mbulimit të koston së transportit sipas konceptit të rezidencës, si dhe informacioni i mbledhur gjatë takimeve me agjencitë e shpërndarjes në vend, shërbyen si bazë në përlogaritjen e zërit përkatës (transport mallrash) në seksionin e shërbimeve në BP (shih më poshtë).

- **Kostoja e sigurimit të mallrave.** Nga vrojtimi doli se **në shumicën e rasteve mallrat nuk janë siguruar**. Përsa i përket tarifës së sigurimit të mallrave të përlogaritur nga rezultatet e vrojtimit dhe të konfirmuar nga takimet direkte me agjencitë kryesore të sigurimit, përfundimi ynë është që **kostoja e sigurimit të mallrave nuk kalon 1 për qind të vlerës së mallit**. Kjo çon në përfundimin se vlera prej 3 për qind e aplikuar deri në vitin 2002 e ka mbivlerësuar disi realitetin.

Aplikimi i koeficientëve të nxjerrë nga vrojtimi (si kosto për transportin dhe sigurimin e mallrave) ka dhënë një efekt të agreguar në *llogarinë korente* të Bilancit të Pagesave.

Këta koeficiente përdoren për kthimin e importeve nga vlera c.i.f. në f.o.b. si edhe për vlerësimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në shërbime.

- Mallra: Vlera e importeve në f.o.b. pas zbritjes së 12.05 për qind të vlerës c.i.f. si kosto transporti dhe 1 për qind të saj si kosto sigurimi, të deficitit tregtar. rezulton në 1783.5 nga 1845 milionë usd. Kjo gjë shkakton një ulje prej 61.5 milionë dollarësh të importeve dhe një reduktim prej 4.4 për qind të deficitit tregtar.

- Shërbime: Aplikimi i kostove të reja ndikon të dyja kahet e bilancit pra si kreditin ashtu edhe debitin e llogarisë 'shërbime'.

1. *Shërbime transporti mallrash* – navllo: Nga aplikimi i koeficientëve të përlogaritur mbi përballimin e kostos së transportit të mallrave nga palët rezidente dhe jorezidente, rezulton rënia e shpenzimeve për transport mallrash me 6.1 milionë usd (debiti i zërit *shërbime transporti mallrash*) dhe njëkohësisht rritja e të ardhurave nga ofrimi i shërbimit të transportit (kreditin e zërit *shërbime transporti mallrash*) me 38.4 milionë dollarë.

2. *Shërbime sigurimi* (mallrash): Një pjesë e shpenzimeve për sigurim (debiti i këtij zëri) vlerësohet me 3 për qind të vlerës c.i.f. të importit si tarifë për sigurimin e mallrave. Aplikimi i kostos prej 1 për qind të sigurimit çon në reduktimin me 37 milionë usd të shpenzimeve për sigurim.

Efekti i agreguar i aplikimit të koeficienteve të përlogaritur nga vrojtimi në llogarinë shërbime, çon në mbylljen e kësaj llogarie me një deficit prej 82.7 milionë usd nga një deficit prej 164.5 milionë usd. Rrjedhimisht, aplikimi i kostove të nxjerra nga vrojtimi, për transportin dhe sigurimin e mallrave, çon në tkurrjen e deficitit korent me 26 për qind.

<sup>1</sup> **F.o.b. (free on board):** vlerësimi i mallrave në çmim tregu, në kufirin e ekonomisë nga e cila janë eksportuar, duke përjashtuar shërbimet e transportit dhe të sigurimit.

<sup>2</sup> **C.i.f. (cost, insurance and freight):** vlerësimi i mallrave në çmim tregu, në kufirin e ekonomisë në të cilën importohen, duke përfshirë koston e transportit dhe të sigurimit.

<sup>3</sup> Duke qenë se shërbimet e transportit ofrohen në masë të konsiderueshme nga agjenci spedicioni shqiptare, të cilat operojnë në bashkëpunim me kompani jorezidente, pagesat përkatëse shpërndahen si brenda, ashtu edhe jashtë vendit. Për të përcaktuar raportet e kësaj shpërndarjeje është marrë kontakt me agjencitë e spedicionit, të regjistruara pranë Ministrisë së Transportit. Gjithashtu, një tjetër interesim i yni ishte marrja e opinioneve mbi firmat e huaja transportuese, që operojnë në tregun e transportit të mallrave (për të patur një vlerësim mbi pjesën e tregut që mbulojnë kompanitë e huaja të transportit dhe atë që mbulojnë ato shqiptare).

### **-Shërbime të tjera.**

Kategoria 'shërbime të tjera' është mbyllur me një deficit prej 10 milionë dollarësh. Gjatë vitit 2003, vendi ka gjeneruar një fluks të ardhurash prej 126 milionë dollarësh ose 60 për qind më shumë të ardhura se sa viti paraardhës. Ndërkohë, kanë dalë jashtë ekonomisë tonë rreth 136 milionë dollarë në këmbim të shërbimeve që rezidentët shqiptarë kanë siguruar nga bota e jashtme. Ky import i lartë shërbimesh është shkaktuar kryesisht si pasojë e rritjes së shpenzimeve për asistencë teknike, që vendi ynë ka vazhduar të sigurojë nga jashtë. Këto shpenzime, gjatë vitit 2003 kanë kapur shifrën 44 milionë dollarë, duke qenë ndjeshëm më të larta se shpenzimet prej 8 milionë dollarësh të një viti më parë. Një zhvillim pozitiv është vërejtur në shërbimet e komunikacionit, që edhe për këtë vit kanë regjistruar një suficit prej 27 milionë dollarësh. Zhvillimi i vullshëm që kanë marrë kohët e fundit shërbimet e telekomunikacionit si edhe marrëdhëniet gjithnjë e më të shpeshta me subjektet jorezidente, kërkojnë zgjerimin e bazës së subjekteve të komunikacionit nga të cilat merret informacion për bilancin e pagesave.

### **II.1.3. Të ardhurat.**

Të ardhurat mbulojnë dy tipe transaksionesh midis rezidentëve dhe jorezidentëve. Këto të ardhura (dhe shpenzime) rrjedhin: nga pagesat për punësimin e përkohshëm të rezidentëve të një ekonomie në një ekonomi tjetër, nga interesat e arkëtueshëm dhe të pagueshëm mbi të gjitha llojet e investimeve që figurojnë në llogarinë financiare, si edhe nga investimi i mjeteve të rezervës. Për vitin 2003, llogaria e të ardhurave është mbyllur me një bilanc pozitiv prej 170 milionë dollarësh, duke shënuar një rritje prej 35 për qind në krahasim me vitin 2002. Rritja më e madhe në hyrjet (kredi) e kësaj llogarie është regjistruar në 'kompensimin e punonjësve'. Të ardhurat nga kompensimi i punonjësve rezidentë të punësuar sezonalisht jashtë Shqipërisë për vitin 2003, janë vlerësuar 110 milionë dollarë ose 25 për qind më të larta se të ardhurat e vitit 2002. Rritje është shënuar edhe në të ardhurat nga interesat mbi investimet e portofolit të rezidentëve jashtë, ndërkohë që interesat e rrjedhur prej investimit të rezervës valutore kanë qenë pothuajse në të njëjtin nivel si për një vit më parë (33 milionë usd). Shqipëria gjatë vitit 2003 ka paguar 17 milionë dollarë për të shlyer interesat mbi borxhin e saj të jashtëm.

### **II.1.4. Transfertat korente**

Transfertat korente, edhe gjatë vitit 2003, ruajtën bilancin thellësisht pozitiv të vërejtur gjatë gjithë dhjetëvjeçarit të fundit. Nëngrupi që zë peshën më të madhe në hyrjet e këtij zëri është 'prurje nga emigrantët'. Këto të fundit, sipas vlerësimit të njësisë së bilancit të pagesave, gjatë vitit 2003 kanë qenë 778 milionë dollarë ose 23 për qind më të larta nga prurjet e vlerësuara për vitin 2003. Këto të ardhura (neto) në valutë, kryesisht në euro dhe në dollarë, kanë financuar më shumë se 60 për qind të deficitit tregtar. Duhet pasur parasysh se metodologjia e përdorur për vlerësimin e remitançave, lejon që në këtë zë të klasifikohen edhe prurje të tjera në valutë të paklasifikuara tjetërkund, që përdoren për financimin e importeve të mallrave dhe të shërbimeve. Për këtë arsye, një metodë që do të përqëndrohej në matjen e drejtpërdrejtë të të ardhurave nga emigrantët duke shfrytëzuar statistikat për emigrantët dhe prurjet mesatare për emigrant, mund të rezultonte në shifra më të sakta por më të ulëta për këtë zë. Box-i 4 jep më shumë detaje mbi një përpjekje të Bankës së Shqipërisë për vlerësimin e saktë të remitançave që kanë hyrë në Shqipëri gjatë vitit 2002.

#### **Box 4. Vlerësim alternativ i prurjeve nga emigrantët (remitancat).**

Zyra e bilancit të pagesave prej disa vitesh aplikon një metodologji të vetën për vlerësimin e prurjeve nga emigrantët në vend. Vlerësimi i remitancave realizohet nëpërmjet një matrice që pasqyron hyrjet dhe daljet e njohura të valutës në tregun paralel, i cili supozohet se është gjithnjë në ekuilibër. Ajo pjesë e importeve të mallrave dhe të shërbimeve për të cilën nuk ka burime të vërtetuara financimi në valutë, konsiderohet si prurje e valutës nga jashtë. Kjo mënyrë vlerësimi, edhe pse ka një mbështetje logjike, bën që shifra e vlerësuar si dërgesë nga emigrantët, të përfshijë edhe valutë të gjeneruar nga burime të tjera siç janë aktivitete jo të ligjshme dhe aktivitete joformale që kryhen midis rezidentëve dhe jorezidentëve. Për këtë arsye në vitin 2003, u bë një përpjekje për të vlerësuar remitancat për vitin 2002 duke mbledhur informacion prej palës përfituese në vend, pra prej familjeve të emigrantëve. Në fazën e tretë të vrojtimit për 'Opinionin e Konsumatorit' të organizuar nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me INSTAT, u përfshi një seksion i veçantë që kërkonte nga familjet informacion për frekuencën, për sasinë, për mënyrën e përdorimit dhe të marrjes së remitancave, në rast se ato përfitonin të tilla. Rezultatet për prurjet mesatare në vit për familje, u shumëzuan me numrin total të familjeve që janë regjistruar si përfituese të të ardhurave nga emigrantët. Ky numër, sipas Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave, INSTAT, 2001, është 145,380 familje. Nga vrojtimi dolën përfundimet e mëposhtme:

- **Rreth 70 për qind e emigrantëve që iu dërgojnë para familjeve të tyre janë të vendosur në Itali dhe Greqi.** Në Greqi jetojnë emigrantë që i kanë familjet e origjinës në qytetet e jugut: në Korçë, në Gjirokastër si edhe në Elbasan, ndërsa emigrantët e larguar nga Durrësi, Vlora, Shkodra e Berati janë vendosur kryesisht në Itali.

- **Vlera mesatare e dërgesave nga emigrantët për familje gjatë vitit 2002 ka qenë 634 euro.** Rreth 48 për qind e familjeve kanë marrë dërgesa në intervalin 200-600 euro. Duke u nisur nga vlera mesatare, është llogaritur vlera e përgjithshme e prurjeve nga emigrantët për vitin 2002. **Kjo vlerë është rreth 92 milionë euro ose 7 herë më e vogël se shifra e vlerësuar për dërgesat në bilancin e pagesave.** Mospërputhja besohet se vjen kryesisht prej metodës së vlerësimit të dërgesave, e cila lejon përfshirjen e të ardhurave të tjera në valutë në këtë zë, si edhe prej raportimeve të pasakta gjatë vrojtimit.

- **Tendenca për rënie të dërgesave nga emigrantët është më e fortë se ajo për rritje**, ndërkohë që pjesa më e madhe e të intervistuarve deklarojnë se situata ka qenë e pandryshuar gjatë viteve 2002-2003.

- **Rreth 76 për qind e emigrantëve përdorin rrugë jozyrtare për të dërguar para pranë familjeve.** Ata që përdorin Western Union janë dy herë më të shumtë se ata që përdorin bankat, ndoshta për shkak të dokumenteve që kërkohen nga këto të fundit.

- Në pjesën më të madhe të rasteve, **të ardhurat nga emigrantët, përdoren për të plotësuar nevojat për konsum**, ndërkohë që ndërtime, investimet, trajtimet mjekësore, kursimet etj. mbulohen me të ardhura të tjera të familjeve. Familjet që përfitojnë dërgesa rezultojnë të jenë familje të nivelit të mesëm financiar, pra të bëjnë pjesë në atë grup që e përballon jetesën pa marrë borxhe, por gjithashtu pa kursyer.


**Vlen të theksohet se një pjesë e mirë e përfundimeve të këtij vrojtimi janë të përafërta me përfundimet e Anketës së Nivelit të Jetesës së realizuar nga INSTAT në vitin 2001.** Nga kjo anketë, prurjet mesatare në vit për emigrant rezultuan 670 dollarë amerikanë. Kjo tregon se mostra e përzgjedhur për vrojtimit, përfaqëson deri-diku mirë karakteristikat e popullatës së synuar për mbulim.

Diferenca midis vlerës së përlogaritur në bazë të rezultateve të këtij vrojtimi dhe vlerës së paraqitur në bilancin e pagesave për remitancat në vitin 2002, edhe nëse marrim parasysh pasaktësitë dhe mangësitë e vrojtimit, duhet marrë si një sinjal për të theksuar rëndësinë e shfrytëzimit të metodave të tjera alternative të vlerësimit.

## II.2. Llogaria kapitale dhe financiare

Gjatë 10 viteve të fundit llogaria kapitale dhe financiare e Shqipërisë ka regjistruar rregullisht hyrje neto kapitali të përfaqësuar kryesisht nga investimet direkte, nga huamarrja shtetërore dhe nga transfertat kapitale. Të gjitha këto flukse kanë bërë që detyrimet e rezidentëve ndaj jorezidentëve të rriten nga viti në vit. Nga ana tjetër, daljet e kapitalit nga Shqipëria kanë konsistuar në vendosjen e depozitave të bankave rezidente jashtë dhe vitet e fundit në investime portofoli. Edhe pse pozicioni ndërkombëtar i investimeve të Shqipërisë nuk hartohet akoma (pozicionet stok të mjeteve dhe detyrimeve), nga të dhënat mbi flukset në vite, mund të themi se Shqipëria është një huamarrëse neto.

**Grafik 10. Llogaria kapitale dhe financiare gjatë viteve 1994-2003 (flukse në milionë usd).**




Viti 2003 regjistroi një fluks neto kapitalesh prej rreth 360 milionë dollarësh amerikanë, të cilat financuan deficitin korent në masën 88 për qind. Transfertat e kapitalit regjistrojnë rreth 157 milionë dollarë duke qenë 29 për qind më të mëdha se ato të vitit paraardhës, ndërkohë që llogaria financiare paraqitet me një bilanc pozitiv prej 202 milionë dollarësh. Fluksi hyrës i kapitaleve është realizuar kryesisht prej thithjes së investimeve të huaja direkte dhe prej lëvrimeve të kredive afatgjata dhe të zbutura nga jashtë. Këto hyrje kanë bërë që detyrimet financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës të rriten me 328 milionë dollarë. Kjo rritje vlerësohet 22 për qind më e lartë se ajo e një viti më parë. Flukset dalëse të kapitaleve gjatë vitit 2003 kanë qenë kryesisht në formën e depozitave të sistemit bankar jashtë si dhe në formën e investimeve të portofolit, të cilat kanë rritur pretendimet financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës me 126 milionë dollarë amerikanë ose, rreth dy herë më shumë se gjatë vitit 2002.

### II.2.1. Investimet direkte

Flukset e kapitalit në formën e investimeve të huaja direkte në Shqipëri për vitin 2003, vlerësohen në nivelin 178 milionë dollarë ose 32 për qind më të larta se ato të vitit 2002. Këto flukse kapitali janë shndërruar në një faktor dominues në rritjen e detyrimeve financiare dhe në zhvillimet e transaksioneve kapitale e financiare duke zënë rreth 54 për qind të bilancit pozitiv të llogarisë financiare. Investimet e huaja direkte në Shqipëri për vitin 2003, reflektojnë kryesisht aktivitetin e kompanive të huaja për kërkimin dhe nxjerrjen e naftës, si dhe aktivitetin e kompanive të telefonisë celulare në vend.

### Box 5. Investimet e huaja direkte në Shqipëri.

Investimet e huaja direkte prej vitesh kanë përfaqësuar flukset më të mëdha hyrëse në anën e detyrimeve në llogarinë financiare të Shqipërisë. Investimet e huaja direkte (IHD), prej vitesh janë konsideruar të dobishme për ekonominë e zhvilluara, por sidomos për ekonominë në tranzicion. IHD vlerësohen së pari, si një burim i rëndësishëm për mbulimin e deficitit korent dhe të atij fiskal (në rastin e IHD-ve që rrjedhin nga privatizimi); së dyti, krahasuar me mundësitë e tjera të financimit, IHD-të mundësojnë transferimin e teknologjisë dhe të përhapjes së njohurive, ndikojnë në hapjen e vendeve të reja të punës, ndihmojnë kompanitë e brendshme të zgjerohen në tregjet e huaja etj.. Ligji 'Për investimet e huaja' (nr.7764, datë 02.11.1993) si edhe legjislacioni që rregullon lëvizjen e kapitalit nga ana e Bankës së Shqipërisë (Rregullorja 'Për veprimtarinë valutore'), synojnë të krijojnë një klimë të favorshme për investitorët e huaj në vend. Ky legjislacion lejon jo vetëm hyrjen lirisht të kapitalit të huaj në pothuajse të gjithë sektorët ekonomikë, por edhe daljen e kapitalit të rrjedhur nga investimi. Përveç trajtimit kombëtar, Shteti Shqiptar garanton investitorët e huaj që: (i) për investimet e huaja nuk nevojitet autorizim paraprak; (ii) nuk ka kufizime për pjesëmarrjen e kapitalit apo drejtimit të huaj në një kompani rezidente; dhe (iii) investimet e huaja nuk mund të shpronësohen ose të kombëtarizohen direkt ose indirekt përveçse në raste të veçanta, në interes të përdorimit publik, sipas përkufizimeve në ligj. Shqipëria ka nënshkruar marrëveshje me një numër shtetesh për mbrojtje të dyanshme të investimeve dhe për evitimin e taksimit të dyfishtë të investitorëve.



Megjithëse Shqipëria paraqet relativisht më pak kufizime mbi veprimtarinë e investitorëve të huaj në krahasim me shtetet e tjera të Evropës Juglindore, gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, ajo duket të ketë tërhequr më pak investime direkte në krahasim me shtete si Kroacia, Rumania dhe Bullgaria, apo në krahasim me shtete të prekura nga konfliktet e armatosura si Serbia dhe Mali i Zi, IRJ e Maqedonisë dhe Bosnje-Herzegovina.



Në këto vite, ka qenë privatizimi i sektorëve strategjikë ai që ka përcaktuar madhësinë dhe karakterin e investimeve të huaja në vend. Flukset e investimeve direkte janë rritur ndjeshëm gjatë viteve 2000 dhe 2001 si rezultat i privatizimit. Në vitin 2000, 85 për qind e kompanisë shtetërore të telefonisë AMC iu shit me partneritet kompanisë norvegjeze Telenor dhe asaj greke Cosmote, për një vlerë 96 milionë usd. Po në të njëjtin vit u realizua shitja e bankës së dytë më të madhe shtetërore, Bankës Kombëtare Tregtare, tek banka turke Kentbank. Viti 2001 ishte viti i privatizimit të shumë kompanive të mesme shtetërore. Pas këtij viti faza e privatizimit të vogël dhe të mesëm në Shqipëri u konsiderua gati e përfunduar. Po këtë vit një licencë e dytë e telefonisë celulare iu dha partneritetit anglezo-grek, Vodafone-Panafon, për 38 milionë usd. Gjithashtu, u realizua shitja me koncensione e minierave të kromit dhe të bakrit. Shitja e Bankës së Kursimeve (126 milionë usd) pritet të pasohet nga privatizimi i kompanisë shtetërore të sigurimeve INSIG dhe i operatorit të telefonisë fikse Albtelekom.

Me përfundimin e procesit të privatizimit, vëmendje nga ana e Shtetit Shqiptar, i duhet kushtuar tërheqjes së investimeve *greenfield*. Madhësia dhe frekuenca e këtyre investimeve kushtëzohen nga një sërë faktorësh, ndër të cilët faktori më përcaktues për Shqipërinë ka qenë krahu i lirë dhe relativisht i trainuar i punës. Në tërheqjen e investimeve direkte, rol tepër të rëndësishëm luajnë: zhvillimi i përgjithshëm ekonomik, stabiliteti politik, zhvillimi teknologjik, baza ligjore dhe zbatueshmëria e ligjeve, niveli i edukimit të krahut të punës etj.. Situata përgjithësisht problematike në Ballkan, gjatë këtij dhjetëvjeçari, si dhe mungesa e një ambienti të përshtatshëm dhe tërheqës për IHD brenda vendit kanë rezultuar në flukse modeste të këtyre prurjeve në vendin tonë. Arritja e objektivave të tillë si transferimi i teknologjisë dhe rritja e produktivitetit në ekonominë shqiptare, kërkojnë masa afatmesme dhe afatgjata, të cilat nuk duhet të mbeten thjesht në nxitjen e IHD-ve, por gjithashtu, në përcaktimin e sektorëve prioritarë të ekonomisë si dhe në politika të përshtatshme për zhvillimin e shkencës dhe të teknologjisë.

## II.2.2 Investimet e portofolit

Stoku i mjeteve financiare në formën e investimeve të portofolit deri në fund të vitit 2003 arriti nivelin 142 milionë dollarë, ndërkohë që rritja në këto mjete në terma neto gjatë vitit ishte 22.5 milionë dollarë. Investimet e portofolit të rezidentëve jashtë, përfaqësohen tërësisht nga investime të sistemit tonë bankar kryesisht në bono thesari të emetuara nga qeveri të huaja. Investimet e portofolit në dollarë amerikanë zënë rreth 86 për qind të portofolit të përgjithshëm, ndërsa pjesa tjetër është në euro e stërlina angleze.

### II.2.3. Investime të tjera

Borxhi i jashtëm i Shqipërisë në formën e lëvrimeve të kredive afatgjata dhe të atyre të buta nga jashtë, gjatë vitit 2003 u rrit me 155.5 milionë dollarë. Kjo rritje ka përfaqësuar pjesën më të madhe të 'investimeve të tjera' si dhe faktorin e dytë më të rëndësishëm që ka ndikuar në rritjen e detyrimeve financiare të vendit gjatë vitit 2003. Në fluksin e borxhit të përmendur më sipër, përfshihet edhe përdorimi i huave dhe i kredive në Fond prej 11 milionë dollarësh.

Pjesa dërrmuese e kredive afatgjata është përdorur nga Qeveria Shqiptare. Financuesi kryesor i qeverisë, ashtu sikurse edhe në vitet paraardhëse, mbetet Banka Botërore nëpërmjet Agjencisë Ndërkombëtare të Zhvillimit (IDA). Shërbimet e borxhit të jashtëm në formën e pagesave të principalit, gjatë vitit regjistruan rreth 37 milionë dollarë. Vëllimi i depozitave të rezidentëve me institucione jorezidente është disa herë më i madh sesa vëllimi i depozitave të jorezidentëve në Shqipëri.

Në anën e detyrimeve, depozitat e jorezidentëve në sistemin tonë bankar për vitin 2003, në terma neto, janë rritur me 19 milionë dollarë, ose pothuajse 2.2 herë më shumë se vitin e kaluar, duke ndikuar kështu në rritjen e detyrimeve të huaja financiare të Shqipërisë. Në fund të vitit 2003 totali i këtyre depozitave arriti në 128 milionë dollarë amerikanë. Pjesa më e madhe e këtyre depozitave (rreth 80 për qind) është në euro, 15 për qind në usd dhe 5 për qind në monedha të tjera. Në anën e mjeteve, depozitat e sistemit tonë bankar jashtë kanë shënuar rritje përgjatë vitit me rreth 32 milionë dollarë amerikanë. Në fund të vitit 2003, ato regjistruan një total prej 525 milionë dollarësh amerikanë. Më tepër se gjysma e këtyre depozitave (52 për qind) është në dollarë amerikanë, ndërkohë që depozitat në euro përfaqësojnë 46 për qind të këtij portofoli. Depozitat e rezidentëve jashtë, sipas statistikave të disponueshme, përfaqësojnë stokun më të madh të pretendimeve të rezidentëve ndaj jorezidentëve.


Në këtë drejtim mendohet se ndikon lidhja e filialeve apo e degëve me rezidencë në Shqipëri me filialet dhe bankat-mëma jashtë vendit. Peshën më të madhe në rritjen e pretendimeve të huaja financiare të Shqipërisë ndaj botës, gjatë vitit 2003, e ka rritja në mjetet valutore në *cash*. Ndryshe nga viti i kaluar kur këto mjete regjistruan rënie, zotërimet në mjete valutore të publikut këtë vit janë rritur me 35 milionë dollarë. Në mjetet valutore të zotëruara nga sistemi bankar, mjetet në dollarë zënë vetëm 28 për qind të totalit. Rreth 66 për qind e këtyre mjeteve është në euro ndërsa pjesa tjetër në sterlina angleze dhe në franga zviceriane. Kreditë tregtare, që kanë financuar një pjesë të importeve të mallrave gjatë vitit 2003 i rritën detyrimet financiare me 11 milionë dollarë. Kjo rritje ka reflektuar edhe rritjen e importit të mallrave për këtë periudhë.

### III.3. Rezervat

Rezervat valutore të autoritetit monetar gjatë vitit 2003 u rritën me rreth 100 milionë dollarë, duke reflektuar kështu flukset hyrëse në mjete valutore, në formën e kapitaleve financiare. Kjo rritje vlerësohet rreth 3.5 herë më e madhe se ajo e vitit

paraardhës. Rolin kryesor në rritjen e rezervës (duke zënë 99 për qind të kësaj rritjeje) e luajti rritja e investimeve në valutë të huaj, që përfshin depozitat në bankat jorezidente si dhe investimet në mjete portofoli. Niveli i rezervave bruto, në fund të vitit, u vlerësua 1025.6 milionë dollarë. Ky nivel rezervash është i mjaftueshëm për të përballuar 4.8 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

**Grafik 11. Rezervat valutore në milionë usd dhe në muaj importe.**



## Aneks metodologjik 1. Përkufizimet e zërave të bilancit të pagesave dhe burimet e të dhënave.

Zëri	Përkufizimi	Burimi i të dhënave
A. LLOGARIA KORENTE	Llogaria korente paraqet transaksionet në mallra, shërbime, të ardhura dhe transferta korente.	
A. 1. Statistikat e import/eksportit të mallrave.	Eksportet e mallrave (kredi) përfaqësojnë vlerën e mallrave sipas regjistrimeve të deklaratave doganore, ndërsa importet e mallrave (debi) përfaqësojnë vlerën e regjistrimeve sipas deklaratave doganore pasi është hequr vlera e transportit dhe e sigurimit për mallrat dhe pas rivlerësimit për mallrat kontrabandë (f.o.b).	Deklaratat doganore- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.
-Eksporti i energjisë elektrike		Korporata Energjitike Shqiptare
A. 2. Shërbime	Kjo kategori mbulon të gjitha shërbimet që rezidentët e një ekonomie u kryejnë jorezidentëve (kredi) dhe anasjelltas (debi), si edhe disa transaksione në mallra që, për arsye praktike, përfshihen në shërbimet me të cilat ato lidhen.	
A.2.a. Transporti	Kjo kategori përfshin gjithë shërbimet e transportit (detar, ajror e tokësor) që rezidentët e një ekonomie u bëjnë jorezidentëve dhe anasjelltas, duke përfshirë 1. lëvizjen e mallrave, 2. transportin e pasagjerëve, 3. shumat e paguara si qira mbi mjetet e transportit (charter) dhe 4. shërbime ndihmëse të lidhura me to.	
i. Transport mallrash	Shërbimet e transportit të mallrave deri në kufirin e ekonomisë importuese të kryera midis rezidentëve dhe jorezidentëve.	Përqindje e vlerësuar mbi vlerën c.i.f. të importit të mallrave sipas koeficientit të siguruar nga vrojtimi i tregtisë së jashtme.
ii. Shërbime pasagjerësh	Të gjitha shërbimet e kryera ndërmjet ekonomisë hartuese dhe "botës" ose ndërmjet dy ekonomive të huaja në transportin ndërkombëtar të pasagjerëve jorezidentë nga transportuesit rezidentë dhe anasjelltas. Përfshihen këtu edhe shërbimet e kryera brenda një ekonomie nga transportues jorezidentë.	Sistemi Bankar (Formulari Nr. 1 i BP)
iii. Shërbime të tjera transporti	Transporte të tjera përfshin shërbimet që kryhen në porte, aeroporte dhe lehtësira të tjera portuale.	Sistemi Bankar (Formulari Nr. 1 i BP)
A.2.b. Shërbime sigurimi	Kjo kategori mbulon lloje të ndryshme sigurimi që ndërmarrjet e sigurimit rezidente u kryejnë jorezidentëve dhe anasjelltas. Shërbime të tilla mbulojnë sigurimin e mallrave; tipe të tjera të sigurimit direkt dhe risigurimin.	Formulari Nr. 8 i BP për kompanitë e sigurimit +Sistemi Bankar
A.2.c. Udhëtim	Ky zë mbulon kryesisht mallrat dhe shërbimet e përfituara nga turistët (udhëtarët) gjatë vizitave të tyre për një periudhë më të shkurtër se një vit, në ekonominë mikpritëse. Këtu përfshihen mallrat dhe shërbimet që blihen nga ose në emër të vizitorit, si dhe ato që ai i përfiton si dhurata (falas).	Vrojtim i turizmit. Bashkëpunohet me INSTAT dhe me Ministrinë e Rendit.
A.2.d. Shërbime të tjera	Shërbime të papërfshira në kategoritë e mësipërme.	
i. Shërbime komunikacioni	Shërbime telekomunikacioni, që përfshijnë i. transmetimin e zërit, figurës, ose informacione me telefon, teleks, telegram, satelit, etj, si dhe shërbimet e rrjetit të biznesit; si dhe ii. shërbimet postale, që përfshijnë marrjen, transportimin dhe shpërndarjen e letrave, gazetave, periodikëve, broshurave, pakove etj, nga operues rezidentë.	Formulari i telekomunikacionit për kompanitë e telekomunikacionit.
ii. Asistencë teknike	Shërbimet e asistencës teknike mbulojnë të gjitha transaksionet e ndihmës në formë asistence nga qeveritë, institucionet dhe njësitë e huaja të ndihmës dhe bashkëpunimit.	Formulari Nr. 16 i BP nga Ministria e Ekonomisë
iii. Shërbime qeveritare	Shërbimet qeveritare mbulojnë të gjitha transaksionet e kryera nga ambasadat, konsullatat, njësitë ushtarake me rezidentët e ekonomisë në të cilën këto njësi janë vendosur, si dhe të gjithë transaksionet me ekonominë e tjera.	Formular për shpenzimet qeveritare, Ministria e Financave
iv. Shërbime financiare	Shërbime financiare, mbulon shërbimet e ndërmjetësimit financiar si dhe shërbimet ndihmëse (përveç atyre të ndërmarrjeve të sigurimit) ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve.	Sistemi Bankar (Formulari Nr. 1 i BP)
v. Të tjera	Shërbime të tjera të papërmendura më sipër.	Sistemi Bankar (Formulari Nr. 1 i BP)

A.3. Të ardhura	Kategoria e të ardhurave përfshin të ardhurat nga investimet kapitale dhe të ardhurat nga puna.	
3a. Shpërblimet e punonjësve	Kompensimi i punonjësve përfshin pagën, shpërblimet dhe përfitime të tjera, të fituara nga individët jorezidentë në një ekonomi, për punën e kryer për rezidentët e kësaj ekonomie.	Vlerësim i bazuar mbi remitancat
3b. Të ardhura nga investimet	Të ardhurat nga investimet mbulojnë të ardhurat që rrjedhin nga pronësia e njësive rezidente mbi mjetet e huaja financiare.	
i. Interesa mbi rezervat	Interesat mbi Rezervat mbulojnë të ardhura të arkëtueshme dhe të pagueshme nga interesat mbi rezervat në mjete valutore të investuara në formën e depozitave respektivisht nga njësitë rezidente jashtë dhe nga njësitë jorezidente në institucionet financiare rezidente.	Sistemi Bankar, bilancet kontabël
ii. Të ardhura nga borxhi (interesa)	Të ardhurat nga borxhi konsistojnë në interesin e pagueshëm investitorëve direktë nga ndërmarrje të asociuara.	Formulari Nr. 12 i BP, Sistemi Bankar dhe Ministria e Financave
iii. Të ardhura nga kapitali	Të ardhurat nga kapitali ndahen në: i. të ardhura që shpërndahen (dividenti dhe fitimi i shpërndarë i degëve) ii. fitimi i riinvestuar.	Formulari Nr. 1 i BP, Sistemi Bankar
A.4. Transferta korente		
4a. Qeveria e përgjithshme	Ndihma shtetërore nga jashtë i referohet transfertave korrente ndërmjet sektorit shtetëror rezident dhe jorezidentëve.	
i. Asistencë teknike		Formulari Nr. 16 i BoP nga Ministria e Bashkepunimit Ekonomik
ii. Ndihma në Cash		Sistemi Bankar dhe Banka e Shqipërisë.
iii. Mallra dhe të tjera ndihma		Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
4.b. Dërgesa nga emigrantet	Dërgesat e emigrantëve i referohen vetëm transfertave të atyre migrantëve të cilët janë të punësuar nga një njësi ekonomike në vendin mikpritës, ku ata konsiderohen rezidentë.	Vlerësim i Sektorit të Bilancit të Pagesave
4.c. Transferta të tjera	Transferta të tjera i referohet transfertave korrente, përveç atyre që përfshihen në dërgesat e emigrantëve, ku njësi rezidente nuk është pjesë përbërëse e sektorit qeveritar.	Formulari Nr. 1 i BP, Sistemi Bankar, Ministria e Rendit
B. LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE		
I. Transferta kapitale	Transferta kapitale konsistojnë në: i. transferimin e pronësisë mbi mjetet fikse, ose ii. në faljen e një detyrimi nga një kreditor.	
1. Falje borxhi	Faljet ose anulimet e një detyrimi nga ana e kreditorëve.	Ministria e Financave
2. Të tjera	Investimet ndihma me qëllim shtesën ose financimin e formimit të kapitalit fiks të ekonomisë perfituese.	Ministria e Ekonomisë

II. Llogaria financiare	Detyrime+ Mjete të rezidentëve ndaj jorezidentëve: Një llogari financiare pozitive tregon se vendi gjatë periudhës ka thithur më shumë kapitale nga ç'ka nxjerrë jashtë vendit. Kjo për arsye se detyrimet rezidentëve ndaj jorezidentëve janë rritur më tepër se pretendimet e rezidentëve ndaj jorezidentëve.	
1. Detyrime	Të gjitha detyrimet në mjete financiare që rezidentët e një ekonomie kanë ndaj jo-rezidentëve.	
1.a. Investimet e huaja direkte	Investimi direkt është kategoria e investimeve ndërkombëtare në të cilat një njësi rezidente synon sigurimin e një interesi të qëndrueshëm në një ndërmarrje të një ekonomie tjetër. Në ndërmarrjen e investimit direkt investitori direkt (rezident i një ekonomie tjetër) zotëron 10 për qind ose më shumë të aksioneve të zakonshme ose të fuqisë votues.	Informacion i marrë nga disa kompani të mëdha të huaja si edhe vlerësime të FMN.
1.b. Huamarrje	Mjete financiare të krijuara përmes huadhënies direkte të fondeve nga një kreditor për një debitor. Zakonisht afatgjatë.	
1.b.1. Huamarrje shtetërore	Huamarrje në të cilën debitor në marrëveshjen e huasë është qeveria e përgjithshme.	Formulari Nr. 12 i BP, Ministria e Financave
1.b.2. Huamarrje e sektorëve të tjerë	Huamarrje në të cilën debitor në marrëveshjen e huasë janë sektorë të tjerë publikë dhe privatë.	Formulari Nr. 12 i BP, Sistemi Bankar dhe EBRD.
1.c. Përdorim kredish nga Fondi	Lëvrimi i kredive nga Fondi, duke përfshirë përdorimet e transheve të pozicionit të rezervës së vendit anëtar.	Banka e Shqipërisë
1.d. Shlyerje kredish	Shlyerja e principalit (jo e interesave) të kredive të marra nga të gjithë sektorët.	Formulari Nr. 12 i BP, Sistemi Bankar dhe Ministria e Financave
1.e. Monedha dhe depozita	Detyrime financiare në formën e llogarive dhe depozitave të bankave dhe të individëve jorezidentë në sistemin tonë bankar.	Bilancet Valutore të Sistemit Bankar
1.f. Kredi tregtare	Kreditë tregtare konsistojnë në detyrimet dhe pretendimet që lindin nga kreditimi (nga furnizuesit dhe blerësit), për transaksionet në mallra dhe shërbime si dhe parapagesat për punimet në proces (ose që do të ndërmerren) të lidhura me këto transaksione.	Vlerësim i bazuar mbi rezultatet për kreditë tregtare - Vrojtimi i tregtisë së jashtme.
1.g. Ndryshime në detyrimet e prapambetura	Detyrime që lindin nga marrëveshjet e huamarrjes dhe nuk shlyhen gjatë periudhës përkatëse.	Formulari Nr. 12 i BP, Sistemi Bankar dhe Ministria e Financave
2. Mjete		
2.a. Investime kapitale	Investime në ekonomi jorezidente ku më shumë se 10% e kapitalit zotërohet nga rezidentët të Shqipërisë.	Nuk raportohet nga asnjë njësi.
2b. Investime portofoli	Investime në letra me vlerë të pasurisë, të borxhit, instrumenta të tregut monetar dhe derivatet financiare, përjashtuar ato që përfshihen në investimet direkte ose mjetet e rezervës.	
2b. Depozita	Mjete financiare në formën e llogarive dhe depozitave të sistemit bankar në bankat e huaja.	Bilancet Valutore të Sistemit Bankar
2c. Monedhë	Kartëmonedhat dhe monedhat në valutë të huaj në zotërim të individëve e bankave që përdoren për të kryer pagesat me jorezidentët.	Bilancet Valutore të Sistemit Bankar, vlerësim nga sektori për valutën e prurë nga emigrantët.
2d. Mjete të tjera	Të tjera mjete/detyrime mbulojnë çdo element tjetër që nuk përfshihet në zërat e përmendur më lart.	Bilancet Valutore të Sistemit Bankar, etj.
C. REZERVAT	Mjetet e rezervës konsistojnë në ato mjete të jashtme që janë menjëherë të përdorshme dhe kontrollohen nga autoritetet monetare për financimin direkt të çbalancimeve (deficiteve) në pagesa, për rregullimin indirekt të madhësisë së këtyre çbalancimeve nëpërmjet ndërhyrjeve në tregjet valutore duke ndikuar mbi kursin e këmbimit të monedhës, dhe/ose për qëllime të tjera.	Banka e Shqipërisë.


## PËRMBLEDHJE- ANALIZË E REZULTATEVE TË VROJTIMIT TË TURIZMIT PËR VITET 2002-2003<sup>1</sup>

### 1. Hyrje

Turizmi ndërkombëtar<sup>2</sup>, për të cilin interesohen hartuesit e bilancit të pagesave, që prej disa vitesh është bërë i pranishëm edhe në Shqipëri. Aktualisht, aktiviteti i turizmit përfaqëson një nga burimet kryesore të të ardhurave në valutë për ekonominë shqiptare. Këto të ardhura janë rritur nga 67 milionë dollarë në vitin 1994, në 522 milionë dollarë në vitin 2003, një vlerë kjo rreth 17 për qind më e lartë se vlera e eksporteve të mallrave.

Vrojtimi i turizmit është vrojtimi me frekuencën më të lartë dhe me përdorimin më të drejtpërdrejtë në bilancin e pagesave. Ai synon të sigurojë vlerësimet për të ardhurat dhe shpenzimet për udhëtime (turizëm). Arsyet përse Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me INSTAT, ndërmerr 5 herë në vit një vrojtim të tillë janë dy: Së pari, shifrat e vlerësuara për të ardhurat dhe shpenzimet për turizmin tregojnë se kjo kategori, zë peshën më të madhe të shërbimeve totale. Në grafikun më poshtë, paraqiten të ardhurat dhe shpenzimet për shërbimet e turizmit dhe për të tre llojet e tjera të shërbimeve gjatë viteve.

**Grafik: Të ardhurat (hyrje) dhe shpenzimet (dalje) për turizëm dhe për shërbimet e tjera, në milionë usd.**



Së dyti, statistikat e përfthuara nga formularët e raportimit të bankave, tregojnë se vetëm një pjesë shumë e vogël e pagesave për turizëm kalohen nëpërmjet sistemit bankar. Sa më tepër një ekonomi të jetë e orientuar drejt pagesave në *cash*, aq më tepër, përdoren për nevoja të bilancit të pagesave vrojtme të kësaj natyre. Në materialin në vijim, shpjegohet se si rezultatet bruto të vrojtimit të turizmit "përkthehen" në shifrat që figurojnë në bilancin e pagesave, si edhe paraqitet një analizë krahasimore e zhvillimeve në turizëm për vitet 2002 - 2003.

<sup>1</sup> Shënim: Materialin e plotë mund ta gjeni pranë Sektorit të Bilancit të Pagesave dhe Vrojtimeve.

<sup>2</sup> Për përkufizime të turizmit dhe të termave të lidhur me të në bilancin e pagesave, konsultohuni me fjalorin në aneksin bashkëngjitur.

## 2. Metodologjia e vrojtit

Metodologjia është paraqitur sipas hapave në të cilët është kryer çdo fazë e vrojtit që nga viti 1999.

**a - Qëllimi i vrojtit** - Qëllimi i këtij vrojti është mbledhja e informacionit mbi ditëqëndrimin mesatar dhe shpenzimet mesatare ditore të turistëve rezidentë dhe jorezidentë, gjatë udhëtimeve të tyre përkatësisht jashtë dhe brenda Shqipërisë.

**b - Përcaktimi i popullatës** - Popullata që synohet të mbulohet në këtë vrojtim përbëhet nga dy grupe. Njëri është grupi i turistëve rezidentë (me kombësi shqiptare ose jo) që kthehen nga udhëtimi jashtë shtetit dhe tjetri është grupi i turistëve jorezidentë (me kombësi shqiptare ose jo), që largohen nga Shqipëria pas një udhëtimi turistik. Problematika: Statistikat mbi hyrje-daljet e turistëve sigurohen nga Ministria e Brendshme. Kriteri mbi të cilin ndërtohen këto statistika, është ai i kombësisë dhe jo ai i rezidencës, që do të ishte në përputhje me kërkesat e bilancit të pagesave. Për këtë arsye, në analizën e mëposhtme, termat e përdorur do të jenë "turistë shqiptarë" dhe "turistë të huaj" në vend të turistëve "rezidentë" dhe "jorezidentë".

**c - Zgjedhja** - Zgjedhja është ndërtuar *apriori* dhe është ruajtur e pandryshuar që prej fillimit të vrojtit. Zgjedhja, për secilën nga 5 fazat e vrojtit përgjatë vitit, përbëhet nga 250 turistë që kthehen në Shqipëri dhe 250 turistë që largohen nga Shqipëria. Problematika: Vrojtimi synon të kapë dy mesatare të zgjedhjes - ditëqëndrimin dhe shpenzimet mesatare ditore - të cilat duhet të jenë sa më afër mesatareve të popullatës. Nga zbatimi i formulës për madhësinë e zgjedhjes për shpërndarjen normale, del se numri i turistëve që duhen pyetur për secilin nga të dy grupet duhet të jetë më i madh se 400-450 ose rreth 800-900 turistë për çdo fazë. Zgjedhja aktuale prej 500 turistësh është mjaft e vogël për të përfaqësuar popullatën e turistëve që hyjnë dhe dalin nga vendi edhe gjatë sezoneve më të varfra turistike.

**d - Shpërndarja gjeografike** - Vrojtimi në terren kryhet nëpër pikat kufitare të Shqipërisë. Deri në vitin 2003, shpërndarja e pyetësorëve nëpër pika kufitare – porte, është bërë nga INSTAT. Problematika: Nëse shpërndarja e pyetësorëve sipas porteve bëhet në përputhje me flukset hyrëse dhe dalëse të turistëve në secilin port, del se, disa porte, si për shembull Vlora ose Saranda nuk duhet të merren në konsideratë, ndërkohë që porte si Morina ose Kapshtica, për shkak të lëvizjes së madhe të shtetasve shqiptarë me banim në Greqi ose në Kosovë, domosdoshmërisht duhet të kapen nga vrojtimi.

**e - Kryerja e anketimit në terren** - Anketimi në terren, për të gjitha fazat e vrojtit është kryer nëpërmjet intervistimit të drejtpërdrejtë nga intervistuesit e INSTAT. Anketimi kryhet 5 herë në vit në muajt mars, qershor, korrik, gusht dhe dhjetor. Kjo shpërndarje është bërë në mënyrë që të kapen karakteristikat e turizmit gjatë sezoneve të ndryshme turistike. Problematika: Pavarësisht nga trainimi i intervistuesve, plotësimi i pyetësorëve ka paraqitur probleme të konceptimit nga ana e intervistuesve. Ata drejtohen tek turistët e huaj për të plotësuar pyetësorët




për jorezidentët dhe tek turistët me kombësi shqiptare për pyetëtorët për rezidentët, duke mos përdorur si kriter atë të rezidencës.

**f – Përpunimi i të dhënave-** Hedhja dhe përpunimi i të dhënave realizohen pranë Bankës së Shqipërisë nga operatorë dhe nga specialistë të Zyrës së Bilancit të Pagesave.

### 3. Rezultatet e vrojtimit për vitet 2002 -2003.



Turistët që vijnë në Shqipëri, janë kryesisht rezidentë të vendeve fqinje, dhe konkretisht Italisë (45 %) dhe Greqisë (23 %). Në këtë grup bëjnë pjesë një numër i konsiderueshëm vizitorësh me kombësi shqiptare dhe me banim jashtë. Qëllimi i udhëtimit për të dy llojet e turistëve kushtëzohet nga periudha e vitit. Faza e tretë dhe e katërt (periudha e verës) karakterizohen nga turistë që udhëtojnë për pushime, ndërkohë që fazat e tjera të vitit, kapin kryesisht turistë që lëvizin për qëllime biznesi, për kurim, për shkollë dhe për qëllime të tjera. Rezultatet më të rëndësishme të pyetësorit lidhen me ditëqëndrimin mesatar si edhe me shpenzimet mesatare ditore të turistëve të ndarë sipas kriterëve: rezident/jorezident (këtu: shqiptar dhe i huaj) si edhe udhëtim ‘për qëllime biznesi’ dhe ‘për qëllime personale’. Ditëqëndrimi i turistëve shqiptarë jashtë ka ardhur duke u ulur për ata që udhëtojnë për qëllime biznesi dhe duke u rritur për ata që udhëtojnë për qëllime personale. Për turistët e huaj, qëndrimi në të dyja rastet luhet rreth vlerës së 10 ditëve. Turistët e huaj të të dyja kategorive qëndrojnë më shumë gjatë verës sesa gjatë tremujorëve të tjerë të vitit.

#### Ditëqëndrimi mesatar për turistët shqiptarë dhe të huaj sipas qëllimit të udhëtimit për vitet 2002-2003 (sipas tremujorëve).



Shpenzimet mesatare ditore të turistëve shqiptarë që kanë udhëtuar për arsye personale gjatë dy viteve të fundit janë luhatur midis vlerave 30 dhe 90 usd në ditë, ndërsa shpenzimet e të huajve që kanë ardhur për të njëjtat qëllime në Shqipëri, kanë arritur edhe deri në 120 usd në ditë. Shpenzimet gjatë udhëtimit për qëllime biznesi, si nga të huajt ashtu edhe nga shqiptarët për vitin 2002 kanë qenë në nivelin 40-80 usd. Gjatë vrojtimit të vitit 2003, shpenzimet e raportuara nga të intervistuarit kanë qenë më të larta, sidomos nga ana e udhëtarëve shqiptarë.

**Shpenzimet mesatare ditore për turistët shqiptarë dhe të huaj sipas qëllimit të udhëtimit për vitet 2002-2003 (sipas tremujorëve).**



Shpenzimet mesatare ditore të turistëve shqiptarë që kanë udhëtuar për arsye personale gjatë dy viteve të fundit janë luhatur midis vlerave 30 dhe 90 usd në ditë, ndërsa shpenzimet e të huajve që kanë ardhur për të njëjtat qëllime në Shqipëri, kanë arritur edhe deri në 120 usd në ditë. Shpenzimet gjatë udhëtimeve për qëllime biznesi, si nga të huajt ashtu edhe nga shqiptarët për vitin 2002 kanë qenë në nivelin 40-80 usd. Gjatë vrojtimeve të vitit 2003, shpenzimet e raportuara nga të intervistuarit kanë qenë më të larta, sidomos nga ana e udhëtarëve shqiptarë.

**4. Mënyra e aplikimit të rezultateve të vërtetimit për vlerësimin e shpenzimeve dhe të të ardhurave nga turizmi në bilancin e pagesave.**

Rezultatet e marra nga turistët e huaj përdoren për të vlerësuar të ardhurat nga turizmi (kredi) ndërsa ato të siguruar nga turistët shqiptarë, përdoren për vlerësimin e shpenzimeve për turizëm (debi). Në bilancin e pagesave, si të ardhurat ashtu edhe shpenzimet për turizëm, ndahen në "biznes" dhe "personale". Për këtë arsye, këto dy grupime përpunohen veçmas dhe rezultatet për ditëqëndrimin dhe shpenzimet ditore aplikohen veçan.

Në tabelën<sup>3</sup> më poshtë jepet në mënyrë të përmbledhur rruga që ndiqet për vlerësimin e kredisë dhe debisë për udhëtime (turizëm) për qëllime biznesi dhe personale, për një tremujor të caktuar.<sup>4</sup>


Nga vërtetimi-250 turistë	Nga statistikat e hyrjedaljeve të turistëve: të huaj ose shqiptarë Nr.turistëve=100,000 (1)	Nga vërtetimi-Ditëqëndrimi mesatar (2)	Nga vërtetimi-shpenzimet mesatare ditore (3)	Rezultati përfundimtar Në milionë usd (4)=(1)*(2)*(3)
A%- 60%- biznes	60%*Nr.turistësh=60,000	Biznes-10 ditë	Biznes –100 usd	=60,000*10*100 = 60 milionë usd
B%-40%- personal	40%*Nr.turistësh=40,000	Personal-15 ditë	Personal-80 usd	=40,000*15*80 =48 milionë usd
Totali në bilanc				108 milionë usd

<sup>3</sup> Shifrat janë hipotetike, por mjaft afër vlerave reale për secilën nga kolonat.

<sup>4</sup> Koefficientët për tremujorin e tretë nxirren nga përpunimi i fazës së tretë dhe i asaj të katërt së bashku.

Sipas kësaj skeme janë vlerësuar të ardhurat dhe shpenzimet për udhëtime (turizëm) për bilancin e pagesave që nga viti 1999. Për vitet 2002-2003, vrojtimi ka mundësuar hartuesit e bilancit të pagesave të vlerësojnë shërbimet e udhëtimeve si më poshtë: të ardhura nga turizmi 487 dhe 522 milionë usd dhe shpenzime për turizëm përkatësisht 365 dhe 489 milionë usd. Rritja në shpenzime është dukshëm më e lartë se rritja në të ardhura, gjë që do të thotë që në të ardhmen mund të gjendemi përballë një deficiti të shërbimeve të udhëtimit.

**Grafik: Të ardhurat dhe shpenzimet për udhëtime sipas ndarjes "biznes" dhe "personal" për vitet 2002-2003, si edhe bilanci i shërbimeve të udhëtimit (në milionë usd).**



Vërehet se, si shpenzimet ashtu edhe të ardhurat nga turizmi gjatë tremujorit të tretë, për të dy vitet, kanë qenë më të larta sesa për tremujorët e tjerë. Fluksi i turistëve hyrës dhe dalës gjatë këtij tremujori është mjaft më i madh sesa gjatë pjesës tjetër të vitit. Tremujori që ndjek këtë për nga madhësia e të ardhurave dhe shpenzimeve është ai i katërti, i cili gjithashtu regjistron flukse të larta turistësh në të dyja drejtimet.

## Aneks - Fjalor

**Rezident**- individë ose kompani që e kanë qendrën e interesit ekonomik brenda territorit ekonomik të shtetit, i cili harton statistikën (në rastin tonë, të Shqipërisë). Në lidhje me kategorinë e shërbimeve të turizmit, në të cilën aktorët janë *individët që udhëtojnë*, qendra e interesit ekonomik është shteti, në të cilin individët konsumojnë mallra dhe shërbime si edhe marrin pjesë në procesin e prodhimit të këtyre të mirave.

**Udhëtarë** - Sipas FMN-së, janë individët që qëndrojnë jashtë vendit për më pak se një vit për çdo qëllim tjetër përveçse: (a) për të punuar në një bazë ushtarake,

ambasadë e të tjera agjenci qeveritare, ose (b) për të shoqëruar ose për të qenë nën varësinë direkte të individëve të kategorisë (a) apo (c) për t'u angazhuar direkt në aktivitet prodhues për një njësi rezidente të ekonomisë në fjalë.

**Turistë** – Udhëtarë, të cilët kalojnë të paktën një natë në vendin që vizitojnë.

**“Turizëm” në gjuhën e bilancit të pagesave** – Përbërës i bilancit të pagesave në të cilin regjistrohen transaksionet në mallra dhe shërbime të lidhura me *shpenzimet e turistëve*. Sipas manualit të FMN-së, këto transaksione regjistrohen në debinë dhe kredinë e zërit “udhëtime”.

**Shpenzimet e turistëve** - Shpenzimet totale në mallra dhe shërbime të bëra nga një udhëtar ose për llogari të një udhëtari, për dhe gjatë udhëtimit dhe qëndrimit në destinacion.

**Udhëtim personal** – Shpenzime të bëra nga individë që shkojnë jashtë për qëllime të ndryshme nga biznesi. Këtu përfshihen pushimet dhe aktivitete të tjera argëtuese dhe kulturore, vizita tek miqtë dhe të afërmit, udhëtime për qëllime pelegrinazhi dhe arsye të tjera fetare, edukim, trajtim shëndetësor etj..

**Udhëtim biznesi** – Përfshin shpenzime të bëra nga: a) individë që shkojnë në një vend të ndryshëm nga ai ku punojnë zakonisht, me qëllim që të ndër marrin çfarëdolloj aktiviteti profesional: shitje, takime pune etj. ;b) punëtorë sezonalë dhe kufitarë.

## Analizë e rezultateve të anketës për opinionin e konsumatorit – rubrika e të ardhurave nga emigrantët

### Vlerësim i remitancave për vitin 2002.

#### Karakteristika të zgjedhjes

Njësia e zgjedhjes FAMILJA.

Vëllimi i zgjedhjes 1206 konsumatorë.

Shpërndarja gjeografike e zgjedhjes 17 zona urbane, të cilat përfaqësojnë 86.4 për qind të zonave urbane në Republikën e Shqipërisë.

Vrojtimi ka synuar vjeljen e informacionit nga pjesëtarë që sjellin të ardhura në familje dhe për rrjedhim, njohin strukturën e buxhetit të familjes.

Në anketën për opinionin e konsumatorit të organizuar pranë familjeve në muajin shtator të vitit 2003 nga Banka e Shqipërisë, për qëllime të plotësimit dhe përmirësimit të statistikave të bilancit të pagesave, u përfshi një seksion i veçantë që synonte të mblidhte informacion mbi të ardhurat që dërgohen nga emigrantët në familjet e tyre në Shqipëri. Duke qenë se zgjedhja e popullatës për vajtje nuk është bërë në funksion të qëllimit të sektorit të bilancit të pagesave që është vlerësimi i fluksit vjetor të dërgesave nga emigrantët, kjo anketë është konsideruar si një fazë pilot dhe rezultatet nga analiza duhen marrë me rezervë. Megjithatë, duhet nënvizuar fakti që disa nga gjetjet e këtij vajtje janë tepër të ngjashme me ato të anketës LSMS të Bankës Botërore të realizuar nga INSTAT<sup>1</sup>. Këtu vlen të përmendim rezultatet mbi shpërndarjen e emigrantëve sipas qyteteve të origjinës dhe shteteve të rezidencës si edhe rezultatet mbi prurjet mesatare vjetore për emigrant.

Nga 1206 të anketuar, vetëm 198 prej tyre ose 16.4 për qind raportojnë se marrin të ardhura nga të afërmit e tyre të emigruar jashtë shtetit. Ky raport rezulton më i ulët rezultati i dalë nga Anketa e Nivelit të Jetesës e vitit 1998, e kryer nga INSTAT. Nga kjo anketë ka dalë se një në pesë familje shqiptare përfiton të ardhura nga emigracioni. Këto të ardhura kapin mesatarisht vlerën 10,000 lekë në muaj dhe përdoren kryesisht për të ngritur nivelin e jetesës së këtyre familjeve. Në vlerësimin e mëposhtëm për prurjen mesatare vjetore për familje nga emigrantët, do të përdorim shifrën e raportuar nga INSTAT, pasi gjykojmë se ajo është më afër realitetit nga shifra e përfutur prej këtij vajtje.

Madhësia e mostrës nga e cila është marrë informacion për të ardhurat nga emigrantët është disi më e vogël nga minimumi i nevojshëm për nxjerrjen e rezultateve statistikisht të vlefshme - 200. Megjithatë, duke marrë parasysh që kjo fazë pilot synonte të testonte gatishmërinë e familjeve për të dhënë informacion për këtë pikë, si edhe përshtatshmërinë e pyetjeve të përfshira në anketë, sektori analizoi rezultatet e këtij vajtje. Këto rezultate do të përdoren si udhëzues për një vajtje të mëtejshëm, që do të kryhet vetëm pranë familjeve që kanë emigrantë jashtë. Më poshtë do të gjeni analizën e përgjigjeve për pyetjet sasore dhe cilësore të përfshira në pyetësor.

<sup>1</sup> Referenca: Albania Poverty Assessment, Report No. 26213-AL, World Bank, November 2003, seksioni mbi remitancat, fq131-133.

Në këtë analizë do të përqëndrohemi në disa pika që paraqesin interes përse i përket sasisë, shpërndarjes gjeografike dhe fushave të përdorimit të të ardhurave nga emigracioni. Duke qenë se pyetësi është plotësuar në disa rrethe, kemi mundësi të bëjmë një vlerësim të raportit të numrit të familjeve që marrin të ardhura prej emigrantëve, ndaj numrit të familjeve që raportojnë se nuk marrin të ardhura të tilla për çdo rreth. Raportet e përfuara mund të na japin një ide shumë të përgjithshme rreth gjeografisë së emigracionit në Shqipëri.

Nga anketimi ka dalë se, duke përjashtuar Shkodrën, qytetet e tjera veriore, Krujë, Kurbin, Lezhë, kanë shkallë relativisht të lartë të përgjigjeve pozitive (më shumë se një e treta e familjeve të intervistuar raportojnë se marrin të ardhura nga emigrantët). Në anën tjetër, janë pozicionuar qytetet e qendrës së Shqipërisë, të cilat kanë raportuar të ardhura nga emigrantët në mesatarisht 10 për qind të rasteve<sup>2</sup>. Meqënëse dihet që motivi kryesor i emigracionit është përmirësimi i nivelit të jetesës, kjo lloj shpërndarjeje jep njëfarë ideje edhe mbi hartën e varfërisë së popullsisë së Shqipërisë. Duke qenë se pyetësi kërkonte informacion edhe për shtetin prej nga vijnë të ardhurat, pra për vendbanimin e emigrantit, është bërë një shpërndarje e rasteve sipas qyteteve pritëse dhe shteteve prej nga janë dërguar të ardhurat. Në tabelë janë përfshirë në grupin 'të tjera' shtetet: Angli, Belgjikë, Hollandë, Kanada, Ish-Jugosllavi (Mali i Zi), si edhe rastet kur është plotësuar pjesa e mbetur e seksionit, por nuk është identifikuar shteti prej nga dërgohen të ardhurat. Në kolonën e fundit jepet numri i përgjithshëm i të përgjigjurve për çdo qytet të Shqipërisë. Për qytetet me numër të ulët të përgjigjeve (më pak se 10) rezultatet duhen marrë me rezerva, për shkak të mostrës së kufizuar.

**Tabelë: Shpërndarja e emigrantëve sipas shteteve ku jetojnë dhe familjeve të origjinës në Shqipëri<sup>3</sup>.**

Shkodër	64	7	7	21	14
Krujë	8			92	12
Elbasan	91	9			11
Korçë	70		20	10	10
Fier	33	22	33	11	9
Gjirokastër	88		13		8
Berat	29	71			7
Kurbin	57	43		0	7
Lezhë		67		33	6
Pogradec	33		50	17	6
Kavajë		75		25	4
Sarandë	50		25	0	25
Lushnje				100	2
Shtet/Totali (%)	32	38	8	3	20
					198

Nga tabela vërehet se emigrantët e larguar nga Elbasani, Korça, Gjirokastra, Kurbin e Saranda, janë vendosur në Greqi në mbi 50 për qind të rasteve. Personat që kanë emigruar nga Durrësi, Kavaja, Berati, Lezha dhe Shkodra janë vendosur në Itali në mbi 60 për qind të rasteve. Qytetet e tjera paraqesin një shpërndarje disi më


<sup>2</sup> Këtu përjashtohet Kuçova prej së cilës asnjë familje nuk ka raportuar se merr të ardhura nga emigrantët.

heterogjene të emigrantëve sipas shteteve. Emigrantët e larguar nga Tirana janë vendosur në Greqi dhe Itali në 70 për qind të rasteve, ndërsa ata të Vlorës në 43 për qind të rasteve.

Interesin më të madh për sektorin e bilancit të pagesave në këtë pyetësor e paraqet përcaktimi i vlerave mesatare të të ardhurave nga emigrantët në total dhe sipas shteteve. Shumat e dërguara nga emigrantët pranë familjeve janë raportuar për vitin 2002 në monedhat Euro, Usd, Lek, Dem, Itl dhe Gbp. Për qëllime të analizës, rezultatet përfundimtare do të paraqiten në Euro. Për konvertimin e shumave të shprehura në monedha të tjera janë përdorur kurset mesatare përkatëse për vitin 2002. Nëse llogaritjet do të bëheshin me kurset aktuale lek/usd dhe lek/euro, rezultatet do të ishin mjaft të ndryshme për shkak të ndryshimit të theksuar që ka pësuar kursi i këmbimit euro/usd që prej vitit të kaluar.

Fillimisht u bë një grupim i familjeve sipas të ardhurave vjetore në intervale të përshtatshme për analizë. Nga grafiku i mëposhtëm vërehet se pjesa më e madhe e familjeve, rreth 72 për qind e atyre që raportojnë se marrin të ardhura nga emigrantët, përfitojnë deri në 800 euro në vit. Përqëndrimi më i lartë është rreth vlerave 200-600 euro ndërkohë që një pjesë e familjeve (21 për qind) marrin nga 900 deri në 2000 euro në vit. Për pasojë, mesatarja përfundimtare del pak më e zhvendosur nga pritja që, përndryshe, do të ishte në intervalin 200-500 euro.

**Grafik: Shpërndarja e familjeve sipas të ardhurave vjetore nga emigrantët.**



Mbi bazën e këtyre të dhënave u llogaritën disa vlera mesatare për prurjet nga emigrantët sipas shteteve dhe në total.

<sup>3</sup> Rreshti i parë tregon përqindjen e emigrantëve që sjellin të ardhura në familjet e tyre në Tiranë sipas çdo shteti (në përqindje), ndërsa rreshti i fundit tregon raportin e numrit të emigrantëve për çdo shtet ndaj numrit total të emigrantëve për të cilët është raportuar.

Tabelë: Të ardhurat mesatare nga emigrantët për familje sipas shteteve të emigrimit.

Shtetet (nr. i emigrantëve për kategorinë)	Mesatarja për vitin 2002 (euro)	Mes. e korrigjuar (euro)
Itali (67)	681	646
Greqi (59)	709	534
Shtetet e tjera – (13)	1072	672
Mes. e përgjithshme (152)	787 = 66 euro/muaj	634= 53 euro/muaj

Mesataret e korrigjuara u llogaritën pas heqjes nga çdo grup (grup= shtet) të vlerave ekstreme<sup>4</sup>. Këto vlera shtrembëronin shpërndarjen dhe çonin në përfundim të gabuar mbi mesataren. Mesatarja e llogaritur për shtetet e tjera është jo tepër e besueshme për shkak të numrit të vogël të përgjigjeve. Mesatarja e përgjithshme qëndron midis mesatareve për Italinë dhe Greqinë, por është shumë më pranë asaj të Italisë.

Me llogaritjen e kësaj mesatareje krijohet mundësia e një vlerësimi për prurjen e përgjithshme të emigrantëve në Shqipëri gjatë vitit 2002. Kjo gjë bëhet duke shumëzuar numrin total të familjeve të regjistruara në Shqipëri, i cili është 726,895-shifër kjo e raportuar nga INSTAT pas Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave në vitin 2001<sup>5</sup> me përqindjen e familjeve që kanë raportuar se marrin të ardhura nga emigrantët-20 për qind<sup>6</sup>. Prej këtej del se afërsisht 145,380 familje shqiptare përfitojnë të ardhura nga të afërmit e tyre të emigruar jashtë shtetit. Duke shumëzuar numrin e familjeve që përfitojnë të ardhura me mesataren e llogaritur të të ardhurave – 634 euro në vit, rezulton se gjatë vitit 2002, në Shqipëri kanë hyrë 92,170,540 euro nga emigrantët. Kjo shifër është rreth 7 herë më e vogël se sa shifra e paraqitur në bilancin e pagesave për vitin 2002-631 milionë usd ose 668 milionë euro. Një shifër pak më e lartë – 114,413,588 euro — përftohet nëse përdoret mesatarja e pakorrigjuar - 787 euro.

Mospërputhja e theksuar mund të shpjegohet me dy mënyra:

Së pari, duhet të përmendim përsëri dyshimin mbi rezultatet e vrojtimit, sidomos në lidhje me sasinë e raportuar të të ardhurave. Ajo pjesë e familjeve që është përgjigjur, mund të ketë raportuar shifra më të ulëta se ato reale.

Së dyti, duhet të sqarojmë se, gjatë vlerësimit të shifrës 'transferta nga emigrantët', metodika e përdorur nga sektori i bilancit të pagesave është e tillë që lejon përfshirjen në këtë grup, përveç dërgesave nga emigrantët, edhe të mjeteve të tjera valutore të ardhura prej tregtisë, kontrabandës dhe prej aktiviteteve të tjera që kryhen në tregun joformal.

Transfertat që kryhen për qëllime të këtyre aktiviteteve e 'fryjnë' artificialisht zërin 'transferta nga emigrantët'. Këto flukse valutore nuk mund të eliminohen nga bilanci i pagesave. Për këtë arsye, në të ardhmen do të bëhen vlerësime për identifikimin e

<sup>4</sup> Vlera që i largoheshin mesores (medianës) me 3 ranje ndërkuartilore.

<sup>5</sup> Marrë nga "Popullsia e Shqipërisë në 2001", INSTAT.

<sup>6</sup> Marrë nga "Rezultate të Anketës së Nivelit të Jetesës", Tetor 1998, INSTAT.



tyre dhe për përfshirjen e tyre në zërat përkatës të bilancit të pagesave. Me fjalë të tjera, nëse në të ardhmen, shifra e vlerësuar për të ardhurat nga emigrantët do të tkurret, paralelisht do të bëhet rritja e një zëri tjetër, për shembull e zërit të shërbimeve në bilanc.

Meqënëse në analizën e ekonomisë në përgjithësi dhe në atë të sektorit të jashtëm në veçanti, është i nevojshëm një parashikim i ecurisë së të ardhurave nga emigrantët, ky vërtetim ka kërkuar të marrë opinionin e familjeve për një sërë veçorish që karakterizojnë sjelljen dhe përdorimin e dërgesave.


Fillimisht, familjarët që marrin të ardhura nga të afërmit e tyre emigrantë janë pyetur për ecurinë e këtyre të ardhurave për vitet 2002 dhe 2003 në krahasim me vitin paraardhës. Atyre iu është kërkuar të tregojnë nëse të ardhurat për secilin nga këto vite, kanë qenë më të ulëta, më të larta apo të njëjta me ato të një viti më parë. Nga grafikët e mëposhtëm duket se nuk ka ndryshim të dukshëm në pritshmëritë e familjeve për këto dërgesa nga njëri vit në tjetrin.

**Tabelë: Shpërndarja e tendencave për vitin 2003, sipas përgjigjeve të marra për vitin 2002.**

		Viti 2003		
Viti 2002	në %	Në rritje	Të njëjta	Në rënie
	Në rritje	41	54	5
	Të njëjta	11	62	27
	Në rënie	2	28	70

Nga kombinimi i këtyre përgjigjeve del se 41 për qind e familjeve që kanë raportuar rritje për vitin 2002, kanë marrë të ardhura më të larta edhe në vitin 2003; 54 për qind e tyre i kanë patur të njëjta në vitin 2003 dhe 5 për qind kanë marrë të ardhura më të pakta. Ajo që bie në sy është tendenca e fortë rënëse për të ardhurat e atyre familjeve që kanë raportuar rënie për vitin 2002. Nga këto familje, 70 për qind kanë marrë dërgesa më të ulëta edhe gjatë vitit 2003.

Kur janë pyetur për mënyrën në të cilën familjet përfituese marrin dërgesat në valutë nga të afërmit emigrantë, ato janë përgjigjur në 99 për qind të rasteve. Nga përgjigjet e marra, del se kanalizimi i dërgesave në rrugë zyrtare (nëpërmjet sistemit bankar dhe Western Union) bëhet në vetëm 23 për qind të rasteve, ndërkohë që në 76 për qind të rasteve këto dërgesa vijnë në mënyra të tjera (nga vetë emigrantët apo nëpërmjet të njohurve). Ky rezultat është i përafërt me raportin e vlerësuar nga Banka e Shqipërisë për dërgesat e kanalizuar nëpërmjet rrugëve zyrtare.



